Aleksi nuk e meritonte dashurinë, karakterin që shumë burra ia lakmonin pasi ajo ishte nga ato qe binte ne sy me hijeshinë, elegancën e ngjyra e syve që qe shprehte shpirtin e dlire. Mbase, sepse ishte nje kafshatë që s'kapërdihej lehtë ishte nje ndjellje e për Argjentin.

Ishte mësuar që dhimbjen, zhgënjimin fyerjen ta fshihte brenda vetes.Për çudi po

ndjente që ajo pjesa e kresë ishte më pak e mpirë, sikur ishte çliruar nga një ngërç, që ishte dukur e pamundur ta zgjidhte. Ishte bërë më e fortë. Vendin e keqardhjes për burrin e kishte zënë urrejtja. Ishte fashitur çdo gjë , por po i dhimsej vetja që kishte rënë viktimë e besimit në fatin e saj. Përse kish arritur deri këtu?Përse duhet të duronte aq shumë? Përse i kishte besuar lajkave e premtimeve të Aleksit deri në përdhunimin e ndjenjave, të shpirtit e trupit?

Gishtërinjtë herë i mblidheshin e herë i zgjateshin sikur ishin bërë pjesë e qartësisë së saj.E veshur me një fustan të kaltër të çelët , ashtu pa tualet , me kapsen e flokëve të verdhë si pa kujdes dukej me origjinale në hijeshinë e saj. Ecte e shkujdesur në rrugën e gjerë të blirëve.

Zogjtë akoma cicëronin nëpër krahedegët e shtrira e të mbushura me gjethe e lule te çelura të verdha. Mbushej thellë me frymë e e ndjeu veten sikur gjithë qenia merrte ndjesi të reja.U gjend para portës së lyer në gri të çelët. Zemra po i rrihte fort.Jo s'po kërkonte lëmoshë, por të ndjente atë dashuri që jepte e merrte atë pjesë që të tre kishin diçka të tyren..... diçka të lënë pezull....

ndjente që ajo pjesa e kresë ishte më pak e mpirë, sikur ishte çliruar nga një ngërç, që ishte dukur e pamundur ta zgjidhte. Ishte bërë më e fortë. Vendin e keqardhjes për burrin e kishte zënë urrejtja. Ishte fashitur çdo gjë , por po i dhimsej vetja që kishte rënë viktimë e besimit në fatin e saj. Përse kish arritur deri këtu?Përse duhet të duronte aq shumë? Përse i kishte besuar lajkave e premtimeve të Aleksit deri në përdhunimin e ndjenjave, të shpirtit e trupit?

Gishtërinjtë herë i mblidheshin e herë i zgjateshin sikur ishin bërë pjesë e qartësisë së saj.E veshur me një fustan të kaltër të çelët , ashtu pa tualet , me kapsen e flokëve të verdhë si pa kujdes dukej me origjinale në hijeshinë e saj. Ecte e shkujdesur në rrugën e gjerë të blirëve.

Zogjtë akoma cicëronin nëpër krahedegët e shtrira e të mbushura me gjethe e lule te çelura të verdha. Mbushej thellë me frymë e e ndjeu veten sikur gjithë qenia merrte ndjesi të reja.U gjend para portës së lyer në gri të çelët. Zemra po i rrihte fort.Jo s’po kërkonte lëmoshë, por të ndjente atë dashuri që jepte e merrte atë pjesë që të tre kishin diçka të tyren..... diçka të lënë pezull....

Mimoza doli e para ia hapi portën e iu hodh në qafë me mall.Iu duk sikur dinte nga Argjenti diçka më shumë për ndodhinë e asaj nate.

Oborri i tyre ishte si një parajsëe vogël. Nëshatërvanin në mes të pishinës së kaltër ngrihej shtatorja e një gruaje. Uji që gurgullonte nga goja e saj me presion shpërndante stërkalat, që krijonin një freski mes limonave, portokajve, mandarinave që ishin mbushur plot me frutin e pjekur e akoma ishin me lule të vogla të bardha.

Degët e rrushit të tejzgjatura ishin spërdredhur nëpër tela të holla....pemët e mollës, kumbullës, shegës gjelbëronin brenda rrethinës që në të ndarat lulëzonin trëndafila shumëngjyrëshe ku dominonte e kuqja. Kudo lastarë të harlisur. Nagjazma e rozmarina ishin rrethuar nga jesheboja lejla te çelura.Elda u tërhoq aq shumë nga kjo bukuri e s'po kishte dëshirë të hynte brenda. Kërkonte të harronte. Nuk donte të shpjegohej. Kishte vendosur ta denonconte Aleksin. Ku përdreq iu kujtua në këtëmoment?

Te tre u drejtuan poshtë pëmes së mollës ku ishte tryeza e rrumbullakët me një xham rrethor në ngjyrë të errët që kombinohej bukur me veshjen prej kashte e të karrikeve që i mbanin gjithmonë jashtë. Në mes të tryezës ishte njëvazo e vogël mbushur plot panse shumë-

Mimoza doli e para ia hapi portën e iu hodh në qafë me mall.Iu duk sikur dinte nga Argjenti diçka më shumë për ndodhinë e asaj nate.

Oborri i tyre ishte si një parajsëe vogël. Nëshatërvanin në mes të pishinës së kaltër ngrihej shtatorja e një gruaje. Uji që gurgullonte nga goja e saj me presion shpërndante stërkalat, që krijonin një freski mes limonave, portokajve, mandarinave që ishin mbushur plot me frutin e pjekur e akoma ishin me lule të vogla të bardha.

Degët e rrushit të tejzgjatura ishin spërdredhur nëpër tela të holla....pemët e mollës, kumbullës, shegës gjelbëronin brenda rrethinës që në të ndarat lulëzonin trëndafila shumëngjyrëshe ku dominonte e kuqja. Kudo lastarë të harlisur. Nagjazma e rozmarina ishin rrethuar nga jesheboja lejla te çelura.Elda u tërhoq aq shumë nga kjo bukuri e s'po kishte dëshirë të hynte brenda. Kërkonte të harronte. Nuk donte të shpjegohej. Kishte vendosur ta denonconte Aleksin. Ku përdreq iu kujtua në këtëmoment?

Te tre u drejtuan poshtë pëmes së mollës ku ishte tryeza e rrumbullakët me një xham rrethor në ngjyrë të errët që kombinohej bukur me veshjen prej kashte e të karrikeve që i mbanin gjithmonë jashtë. Në mes të tryezës ishte njëvazo e vogël mbushur plot panse shumë-

ngjyrëshe plotësisht të çelura.Argjenti me vështrimin depërtues të dritëqeshjes së tij kuptoi më shumë se sa mund t'i shprehej Elda. Duke pare valixhen e kuptoi qe Elda kishte marrë një vendim.Mos do të udhëtonte tek prindët drejt qytetit të vogël buzë Jonit? Mbase për disa ditë? Ajo s' duhej të shkëputej nga puna . Ishte e zonja në informatikë e insituti e vlerësonte.

- Sonte do të flesh këtu-i tha Moza me një zë që nuk pranonte kundërshtim.... kemi aq shumë për të thënë ne të dyja e i shkeli syrin Argjentit me buzën në gaz.

- Mund të rrish sa të duash, deri sa diçka të rregullohet. Je si në shtëpinë tënde - i tha ai me ngrohtësi.

Mimoza u ndje ngusht që nuk ia kish thënë këtë, por e thënija e të shoqit iu duk si pa etikë.

- Elda... je bërë yll sonte....

- Ha ha ha qeshi Argjenti valë deti apo dallgë oqeanesh këtë rrallë.

Atyre i ishte bërë si shprehje kur punonin , por Mimoza dalloi diçka ndryshe mes tyre. Elda e lëvizte pak kokën anash, duart që shoqëronin fjalët e saj kishin të njëjtën delikatese,por zëri melodioz kishte një

ngjyrëshe plotësisht të çelura.Argjenti me vështrimin depërtues të dritëqeshjes së tij kuptoi më shumë se sa mund t'i shprehej Elda. Duke pare valixhen e kuptoi qe Elda kishte marrë një vendim.Mos do të udhëtonte tek prindët drejt qytetit të vogël buzë Jonit? Mbase për disa ditë? Ajo s' duhej të shkëputej nga puna . Ishte e zonja në informatikë e insituti e vlerësonte.

- Sonte do të flesh këtu-i tha Moza me një zë që nuk pranonte kundërshtim.... kemi aq shumë për të thënë ne të dyja e i shkeli syrin Argjentit me buzën në gaz.

- Mund të rrish sa të duash, deri sa diçka të rregullohet. Je si në shtëpinë tënde - i tha ai me ngrohtësi.

Mimoza u ndje ngusht që nuk ia kish thënë këtë, por e thënija e të shoqit iu duk si pa etikë.

- Elda... je bërë yll sonte....

- Ha ha ha qeshi Argjenti valë deti apo dallgë oqeanesh këtë rrallë.

Atyre i ishte bërë si shprehje kur punonin , por Mimoza dalloi diçka ndryshe mes tyre. Elda e lëvizte pak kokën anash, duart që shoqëronin fjalët e saj kishin të njëjtën delikatese,por zëri melodioz kishte një

tingëllimë më të fortë. Diçka e pazakontë. Argjentit nuk i shpëtoi ky detaj.

Kur hynë brenda e ishin pak vetëm ai e pyeti i tejmerakosur si ndjehej.Ajo kish bërë shenje me dorë sikur po shpërndante shtëllungën e tymit të duhanit, psherëtiu thellë e i dha të kuptonte që donte të harronte. Për çudi nuk i ndjente dhembjet e trupit, ndërsa shpirti sikur kish shtangur në atë mëdyshje që ajo duhet të gjente veten, në atë natë të freskët,pa mjergull. Ajo ngriti kokën lart kur kishin dalë të tre në ballkon. Dalloi Harushën e Madhe me atë konfiguracion të mahnitshëm në dridhjen e yjeve ... e endërrimtare..... iu duk se po lodronte si dikur e vogël nëpër Rrugën e Qumështit. Natë e lënduar... moj e mira natë...

Darkën e shijshme të përgatitur nga Mimoza, që e kishte pasion guzhinën e shoqeruan me një gotë vere “Martini” që kishte vite pa u hapur. Sapo ajo u largua për të rregulluar krevatin në dhomën ku do flinte Elda, ata të dy po e zhbironin njëri tjetrin në vështrime te ngulitura.

- Duhet të bisedojmë patjeter sonte të dy - i tha Argjentit me një zë të sigurtë.

tingëllimë më të fortë. Diçka e pazakontë. Argjentit nuk i shpëtoi ky detaj.

Kur hynë brenda e ishin pak vetëm ai e pyeti i tejmerakosur si ndjehej.Ajo kish bërë shenje me dorë sikur po shpërndante shtëllungën e tymit të duhanit, psherëtiu thellë e i dha të kuptonte që donte të harronte. Për çudi nuk i ndjente dhembjet e trupit, ndërsa shpirti sikur kish shtangur në atë mëdyshje që ajo duhet të gjente veten, në atë natë të freskët,pa mjergull. Ajo ngriti kokën lart kur kishin dalë të tre në ballkon. Dalloi Harushën e Madhe me atë konfiguracion të mahnitshëm në dridhjen e yjeve ... e endërrimtare..... iu duk se po lodronte si dikur e vogël nëpër Rrugën e Qumështit. Natë e lënduar... moj e mira natë...

Darkën e shijshme të përgatitur nga Mimoza, që e kishte pasion guzhinën e shoqeruan me një gotë vere “Martini” që kishte vite pa u hapur. Sapo ajo u largua për të rregulluar krevatin në dhomën ku do flinte Elda, ata të dy po e zhbironin njëri tjetrin në vështrime te ngulitura.

- Duhet të bisedojmë patjeter sonte të dy - i tha Argjentit me një zë të sigurtë.

- Nesër e dashur, sonte nuk mundem, po e kuptoi ajo do të lëndohet- ngriti zërin Argjenti i tronditur.

Mimoza, që sapo hynte në sallonin e gjerë që ndriçonte nga drita të vogla, në tavanin ngjyrë qumështi me reflekse jeshile ngriu në vend.Nuk mund të bënte asnjë hap para. Zuri veshët me duar, për të mos dëgjuar më, e pa zhurmë hyri në dhomën e gjumit.Filloi t'i merrej fryma. Një lëmsh iu mblodh në fyt, sikur lotët kishin ngrirë aty. Jo.... nuk duhet të shpërthente, nuk duhej t'i binte në sy. Gjithmonë i thonte të shoqit se ajo e donte çmendurisht, sepse kështu dinte tëdashuronte njëherë e përgjith-monë... se të kam Yll.... se të kam të gjithin, se je vetëm i imi... i imi... i imi...! Këmbët s'po e mbanin e u shtri përmbys në krevat.

Eldën e donte si motren e saj e të Argjentit.Sa dashuri e dhimbsuri ndjente per te. Elda i tregonte të gjitha me atë hijeshinë e ëmbëlsinë që të mahniste. Sikur ta falte qiellin, e gjithë kohën ta bënte vetëm pesë minuta mes tërheqjen e bukurisë e adhurimit.Nëpërmjet miqësisë së ngrohtë me të , ajo kish vlerësuar më shumë Argjentin, fatin e saj Yll, e donte ta bënte burrin më të lumtur në botë.Ashtu natyrshëm në çdo moment me ngrohtësinë e

- Nesër e dashur, sonte nuk mundem, po e kuptoi ajo do të lëndohet- ngriti zërin Argjenti i tronditur.

Mimoza, që sapo hynte në sallonin e gjerë që ndriçonte nga drita të vogla, në tavanin ngjyrë qumështi me reflekse jeshile ngriu në vend.Nuk mund të bënte asnjë hap para. Zuri veshët me duar, për të mos dëgjuar më, e pa zhurmë hyri në dhomën e gjumit.Filloi t'i merrej fryma. Një lëmsh iu mblodh në fyt, sikur lotët kishin ngrirë aty. Jo.... nuk duhet të shpërthente, nuk duhej t'i binte në sy. Gjithmonë i thonte të shoqit se ajo e donte çmendurisht, sepse kështu dinte tëdashuronte njëherë e përgjith-monë... se të kam Yll.... se të kam të gjithin, se je vetëm i imi... i imi... i imi...! Këmbët s'po e mbanin e u shtri përmbys në krevat.

Eldën e donte si motren e saj e të Argjentit.Sa dashuri e dhimbsuri ndjente per te. Elda i tregonte të gjitha me atë hijeshinë e ëmbëlsinë që të mahniste. Sikur ta falte qiellin, e gjithë kohën ta bënte vetëm pesë minuta mes tërheqjen e bukurisë e adhurimit.Nëpërmjet miqësisë së ngrohtë me të , ajo kish vlerësuar më shumë Argjentin, fatin e saj Yll, e donte ta bënte burrin më të lumtur në botë.Ashtu natyrshëm në çdo moment me ngrohtësinë e

ndjenjave të saj, që buronin si të gjithë lumenjtë e derdhur në një det pafund lumturie.

Argjenti e puthi Eldën e i premtoi se sapo Mimoza të flinte do vazhdonin bisedën në sallon.
I uruan natën e mirë e ajo i shkeli syrin Mimozës, siç bënin ndonjëherë të dyja për shaka.
U shtrinë të dy në shtrat. Argjenti s'e kish mbledhur vehten, por as ajo jo.

- U kënaqe më shumë, apo u lodhe - e pyeti ai duke ia marrë kokën në gjoksin e tij.

- Po më mbyllen sytë - u hoq ajo sikur donte të flinte.

- Doja të shtërngoja fort .... fort.... e të flije kështu duke dëgjuar rrahjet e zemrës time vetëm për ty.... për ty...rrezehëna më e ndritshme për mua!

Sa dëshironte në moment ta zinte një gjumë i thellë..... të mos dëgjonte....por mes atij dyshimi a mund të flinte? Të ishte e vërtetë se kishte lindur diçka mes tyre? Të ishte tradhëtuar nga të dy njëherësh? Si ishte e mundur? Po dridhej nga një e ftohtë që i përshkoi mornica në trup. Truri sikur po i mpihej.Nuk donte të mendohej.Iu duk sikur duke shtrydhur dyshimin e saj diçka po

ndjenjave të saj, që buronin si të gjithë lumenjtë e derdhur në një det pafund lumturie.

Argjenti e puthi Eldën e i premtoi se sapo Mimoza të flinte do vazhdonin bisedën në sallon.
I uruan natën e mirë e ajo i shkeli syrin Mimozës, siç bënin ndonjëherë të dyja për shaka.
U shtrinë të dy në shtrat. Argjenti s'e kish mbledhur vehten, por as ajo jo.

- U kënaqe më shumë, apo u lodhe - e pyeti ai duke ia marrë kokën në gjoksin e tij.

- Po më mbyllen sytë - u hoq ajo sikur donte të flinte.

- Doja të shtërngoja fort .... fort.... e të flije kështu duke dëgjuar rrahjet e zemrës time vetëm për ty.... për ty...rrezehëna më e ndritshme për mua!

Sa dëshironte në moment ta zinte një gjumë i thellë..... të mos dëgjonte....por mes atij dyshimi a mund të flinte? Të ishte e vërtetë se kishte lindur diçka mes tyre? Të ishte tradhëtuar nga të dy njëherësh? Si ishte e mundur? Po dridhej nga një e ftohtë që i përshkoi mornica në trup. Truri sikur po i mpihej.Nuk donte të mendohej.Iu duk sikur duke shtrydhur dyshimin e saj diçka po

lagej,diçka që ftohej e mes avullit të tyre kish frikë mos formohej për herë të parë në jetën e tyre martesore një shtrese e holle ngrice. Ndjente ftohtë.Kujdesej se mos rrëshqiste si në një pistë patinazhi, që po e kërcente për herë të parë, në një melodi klasike... e po i merrej mendja.Sa shumë i donte të dy! Po i mbushte mendjen vehtes se sonte s'do i ndodhte asgjë.Ia hoqi krahun Argjentit, e puthi lehtë e u kthye në anën tjetër.Ai u shtërngua pas trupit te saj e ndjeu se s' mund të shkonte më tej.. as me fjalë. Ç'të bënte ta kthente Mimozën nga vetja , apo ta linte ashtu? Ai ishte burri që e dashuronte me çmimin e fatit të tij.... për ta dashur e mbrojtur deri në përjetësi.Por çfarë ishte ndjenja për Eldën që e bënte të fluturonte përtej.. ... të digjej e të përvëlohej deri në marramendje? Sa donte ta pinte ate verën deri në fund,të trullosej për të dyja.

A s' ishte ai që kohët e fundit në heshtje në fantazinë e tij e kish shpënë Eldën aty, në atë copë qiell, që i kish takuar vetëm atij e Mimozës? Ia fshihte Mimozës, ia shprehte Eldës , duke e gjetur vehten njëkohësisht në mes të dy dashurive pa përvëluar as njërën, as tjetren por ngrohej vetë çuditërisht më shpejt në një epsh që ai s'e njihte veten, por po e dinte tani vetëm ai.Sa do t'i pëlqente të dyja sonte... marrëzisht...

lagej,diçka që ftohej e mes avullit të tyre kish frikë mos formohej për herë të parë në jetën e tyre martesore një shtrese e holle ngrice. Ndjente ftohtë.Kujdesej se mos rrëshqiste si në një pistë patinazhi, që po e kërcente për herë të parë, në një melodi klasike... e po i merrej mendja.Sa shumë i donte të dy! Po i mbushte mendjen vehtes se sonte s'do i ndodhte asgjë.Ia hoqi krahun Argjentit, e puthi lehtë e u kthye në anën tjetër.Ai u shtërngua pas trupit te saj e ndjeu se s' mund të shkonte më tej.. as me fjalë. Ç'të bënte ta kthente Mimozën nga vetja , apo ta linte ashtu? Ai ishte burri që e dashuronte me çmimin e fatit të tij.... për ta dashur e mbrojtur deri në përjetësi.Por çfarë ishte ndjenja për Eldën që e bënte të fluturonte përtej.. ... të digjej e të përvëlohej deri në marramendje? Sa donte ta pinte ate verën deri në fund,të trullosej për të dyja.

A s' ishte ai që kohët e fundit në heshtje në fantazinë e tij e kish shpënë Eldën aty, në atë copë qiell, që i kish takuar vetëm atij e Mimozës? Ia fshihte Mimozës, ia shprehte Eldës , duke e gjetur vehten njëkohësisht në mes të dy dashurive pa përvëluar as njërën, as tjetren por ngrohej vetë çuditërisht më shpejt në një epsh që ai s'e njihte veten, por po e dinte tani vetëm ai.Sa do t'i pëlqente të dyja sonte... marrëzisht...

të bërtiste me zë të lartë që ishin edhe shokë bashkë… e të çlirohej njëherë e mirë nga ky makth që po e ndjente gjithmonë e më shumë.

Elda pas asaj nate të tmerrshme donte të përhumbej, por priste me ankth Argjentin t'i bënte me shenjë që të ngrihej.Ishte bërë më shumë kurioze se ç'duhej.E kishte detyruar Argjentin pikërisht sonte ta gjenin veten të tre në mes të dy dashurive.

Mos ndoshta Mimoza me çiltërsinë i kish treguar shumë biseda intime, të bëra të dyja e ai ishte tërhequr të zbulonte tek ajo diçka që mund t'i përkiste në intimitet e atij? Apo vetë ajo ishte shtyrë drejt tyre nga dëshpërimet me Aleksin e psherëtimat e saj të thella ishin ndjerë te miqtë e saj të dashur…. shumë të dashur si askush në atë qytet të madh interpol?

Ajo tërhiqte vëmendjen e simpatinë e të gjithëve në çdo rreth të krijuar , duke u bërë enigmë me të fshehtën e saj për të shoqin. Mos ky mister kishte zgjuar kërshërinë e Argjentit? Mos ishte zbuluar në fije të holla nëpërmjet Mimozës e ai po provonte veten në mbrojtjen e një mashkulli për një femër tjetër, që padashur të dy kishin rënë pre e asaj, që kur kthehesh në dicka të dëshiruar në dy gjini të ndryshme bëhej e papërmbajtur? Kjo kërkonte një udhë që sa më e vështirë bëhej, aq më shumë të jepte fuqinë e

të bërtiste me zë të lartë që ishin edhe shokë bashkë... e të çlirohej njëherë e mirë nga ky makth që po e ndjente gjithmonë e më shumë.

Elda pas asaj nate të tmerrshme donte të përhumbej, por priste me ankth Argjentin t'i bënte me shenjë që të ngrihej.Ishte bërë më shumë kurioze se ç'duhej.E kishte detyruar Argjentin pikërisht sonte ta gjenin veten të tre në mes të dy dashurive.

Mos ndoshta Mimoza me çiltërsinë i kish treguar shumë biseda intime, të bëra të dyja e ai ishte tërhequr të zbulonte tek ajo diçka që mund t'i përkiste në intimitet e atij? Apo vetë ajo ishte shtyrë drejt tyre nga dëshpërimet me Aleksin e psherëtimat e saj të thella ishin ndjerë te miqtë e saj të dashur.... shumë të dashur si askush në atë qytet të madh interpol?

Ajo tërhiqte vëmendjen e simpatinë e të gjithëve në çdo rreth të krijuar , duke u bërë enigmë me të fshehtën e saj për të shoqin. Mos ky mister kishte zgjuar kërshërinë e Argjentit? Mos ishte zbuluar në fije të holla nëpërmjet Mimozës e ai po provonte veten në mbrojtjen e një mashkulli për një femër tjetër, që padashur të dy kishin rënë pre e asaj, që kur kthehesh në dicka të dëshiruar në dy gjini të ndryshme bëhej e papërmbajtur? Kjo kërkonte një udhë që sa më e vështirë bëhej, aq më shumë të jepte fuqinë e

një lufte. Të dukej vetja që në secilën fushë betejë të ishe duhej të dilje i fituar. Por Mimoza nuk ishte kundërshtarja.A luftohej me atë shikim përdëllues të syve te zinj, me atë bebëz të lëngëzuar mes një shkëlqimi, me ato qerpikë të gjatëe të kthyer po aq të zinj, që pasqyronin ëmbël vizionin e hapësirës të një shpirti njeriu, që përjetonte çdo fjalë,çdo ndjenjë e ta përcillte me një paqe e mendim të kthjellët?A prekej dashuria e shenjtë që ajo e shprehte me aq pasion? A nuk ishte Mimoza, që për burrin do falte çdo gjë? Jo, për Eldën ajo ishte princeshë e pafajsisë. Por sa të fajshëm ishin ata para saj? Do ishte ndryshe sikur ajo ta kishte afruar me qëllimin për të provuar ndershmërinë e burrit para qenijes, të qenurit me të vërtetë femër nëshkëlqimin e veçantë të një rrezedielli që ngrohte e lodronte në sy të të gjithëve.

Do ishte po aq e papranueshme sikur Mimoza ta afronte për t’i treguar Argjentit se ajo grua e karakterit të veçantë ishte thjesht një grua e dobët nga brenda e s’ish ajo që paraqiste mospërfillje kundrejt meshkujve të tjerë.Po çfarë ishin ato aludime? Do provonte ajo të vuante, duke rrezikuar ndjenjën, sikur e në lëndime xhelozie?

Argjenti, kur mendoi se Mimoza flinte, ia lëmoi faqen lehtë me ëmbëlsi.U çudit! Dora iu

një lufte. Të dukej vetja që në secilën fushë betejë të ishe duhej të dilje i fituar. Por Mimoza nuk ishte kundërshtarja.A luftohej me atë shikim përdëllues të syve te zinj, me atë bebëz të lëngëzuar mes një shkëlqimi, me ato qerpikë të gjatëe të kthyer po aq të zinj, që pasqyronin ëmbël vizionin e hapësirës të një shpirti njeriu, që përjetonte çdo fjalë,çdo ndjenjë e ta përcillte me një paqe e mendim të kthjellët?A prekej dashuria e shenjtë që ajo e shprehte me aq pasion? A nuk ishte Mimoza, që për burrin do falte çdo gjë? Jo, për Eldën ajo ishte princeshë e pafajsisë. Por sa të fajshëm ishin ata para saj? Do ishte ndryshe sikur ajo ta kishte afruar me qëllimin për të provuar ndershmërinë e burrit para qenijes, të qenurit me të vërtetë femër nështkëlqimin e veçantë të një rrezedielli që ngrohte e lodronte në sy të të gjithëve.

Do ishte po aq e papranueshme sikur Mimoza ta afronte për t’i treguar Argjentit se ajo grua e karakterit të veçantë ishte thjesht një grua e dobët nga brenda e s’ish ajo që paraqiste mospërfillje kundrejt meshkujve të tjerë.Po çfarë ishin ato aludime? Do provonte ajo të vuante, duke rrezikuar ndjenjën, sikur e në lëndime xhelozie?

Argjenti, kur mendoi se Mimoza flinte, ia lëmoi faqen lehtë me ëmbëlsi.U çudit! Dora iu

lag nga një lot që i rrëshqiste në gushën e saj të bukur e pikonte në flokun e zi të derdhur në njërën anë.Ndjeu dhimbsuri deri në fijen më të hollë të shpirtit. Mos sheh ndonjë ëndërr e parandjen? U ngrit ngadalë, veshi tutat sportive e bluzën e bardhë me shenjën " nike" që i shkonte shumë. Kur zgjati dorën , të merrte paketën mbi komodinën në ngjyren e arrës,i hodhi e një sy Mimozës që po i dukej me ato tandellat e bardha të këmishës së natës në lejla shumë të hapët , si një perëndeshë e bukurisë.Nga një dënesë e mbytur, të padëgjuar asnjëherë, ndjeu që iu prenë këmbët. Mori një cigare e e vuri ne buzët që po i thaheshin.

- Shpirt.... shpirt i vogël...të dhemb diçka.... ishe mire.... ç' pate?... Ç' ke.... ç' të mundon?

Sikur i ra pika në kokë, kur mendoi se ajo dyshonte? Po t'i kishte dëgjuar?

- Një cigare doja të ndizja - i tha për t'u shfajësuar.

Mimoza u ngrit përgjysmë, rregulloi jastekun, mblodhi këmbët, e i bëri shenjë që të ulej.
Dukej më e zbehtë me refleksin e abazhurit të ndezur.Fshiu lotët e mbuloi fytyrën me duar. Po i vinte vala tjetër e dënesës që i çlironte ngërçin në fyt me frymëmarrjen e vështirë. Jo .... jo i tha

lag nga një lot që i rrëshqiste në gushën e saj të bukur e pikonte në flokun e zi të derdhur në njërën anë.Ndjeu dhimbsuri deri në fijen më të hollë të shpirtit. Mos sheh ndonjë ëndërr e parandjen? U ngrit ngadalë, veshi tutat sportive e bluzën e bardhë me shenjën “ nike” që i shkonte shumë. Kur zgjati dorën , të merrte paketën mbi komodinën në ngjyren e arrës,i hodhi e një sy Mimozës që po i dukej me ato tandellat e bardha të këmishës së natës në lejla shumë të hapët , si një perëndeshë e bukurisë.Nga një dënesë e mbytur, të padëgjuar asnjëherë, ndjeu që iu prenë këmbët. Mori një cigare e e vuri ne buzët që po i thaheshin.

- Shpirt.... shpirt i vogël...të dhemb diçka.... ishe mire.... ç’ pate?... Ç’ ke.... ç’ të mundon?

Sikur i ra pika në kokë, kur mendoi se ajo dyshonte? Po t’i kishte dëgjuar?

- Një cigare doja të ndizja - i tha për t’u shfajësuar.

Mimoza u ngrit përgjysmë, rregulloi jastekun, mblodhi këmbët, e i bëri shenjë që të ulej.
Dukej më e zbehtë me refleksin e abazhurit të ndezur.Fshiu lotët e mbuloi fytyrën me duar. Po i vinte vala tjetër e dënesës që i çlironte ngërçin në fyt me frymëmarrjen e vështirë. Jo .... jo i tha

vehtes...mbahu fort.... nuk duhet.. E ë' i hynin ne punë lotët? A duhej ta tregonte fundin e dobësisë ? Çelësi i ndjenjave duhet të punonte në këtë moment. Të paktën të barazonte arsyen me të, e pse ishte jashtë forcave. Duhej o sonte .... o kurrë..! Ky mendim i dha forcën e duhur.

- Elda të pret, apo jo? Ai dalloi nota irritimi në zërin e ulët.

- Po. Ka ndodhur diçka e lehtë, duke të dashur ty....as vetë s' jemi të qartë...... s' di si ta them moj e mirë. Më pikon në zemër që je aq e lënduar. Të betohem, që ti je ulur si mbretëreshë ne kolltukun e florinjtë brenda shpirtit tim. Je zotëruesja e qiellit tonë të lumturisë. Të përgjërohem..... kuptomë....po nuk deshe ti une nuk shkoj.

- Ajo tëpret.Shko tani! O do të hysh përsëri në dhomën tonë të gjumit me mua,ose ik bashkë me të, pa dalë une që këtej. Zëri i Mimozës ishte i prerë, pa tingullin melodioz,pa atë nën zë të urtësisë.Si vendosmëria e një ulkonje, qe po t'i afroheshe këlyshit, do të vërsulej e egërsuar.

E ndezi çakmakun me duart që i dridheshin. E thithi fort cigaren. Ia shtërngoi dorën të shoqes, sikur kërkonte forcë e pak paqe që t'i falte.

vehtes...mbahu fort.... nuk duhet.. E ë' i hynin ne punë lotët? A duhej ta tregonte fundin e dobësisë ? Çelësi i ndjenjave duhet të punonte në këtë moment. Të paktën të barazonte arsyen me të, e pse ishte jashtë forcave. Duhej o sonte .... o kurrë..! Ky mendim i dha forcën e duhur.

- Elda të pret, apo jo? Ai dalloi nota irritimi në zërin e ulët.

- Po. Ka ndodhur diçka e lehtë, duke të dashur ty....as vetë s' jemi të qartë...... s' di si ta them moj e mirë. Më pikon në zemër që je aq e lënduar. Të betohem, që ti je ulur si mbretëreshë ne kolltukun e florinjtë brenda shpirtit tim. Je zotëruesja e qiellit tonë të lumturisë. Të përgjërohem..... kuptomë....po nuk deshe ti une nuk shkoj.

- Ajo tëpret.Shko tani! O do të hysh përsëri në dhomën tonë të gjumit me mua,ose ik bashkë me të, pa dalë une që këtej. Zëri i Mimozës ishte i prerë, pa tingullin melodioz,pa atë nën zë të urtësisë.Si vendosmëria e një ulkonje, qe po t'i afroheshe këlyshit, do të vërsulej e egërsuar.

E ndezi çakmakun me duart që i dridheshin. E thithi fort cigaren. Ia shtërngoi dorën të shoqes, sikur kërkonte forcë e pak paqe që t'i falte.

- Kthehem shpejt, pas pak minutash , shpirt i shpirtit tim.Përpiqu të jesh e qetë ti të paktën. A ke besim tek unë?- Argjenti tërhoqi derën, për ta mbyllur plotësisht.Elda kish hedhur një mantel të kaltër e po e lidhte në belin e saj të hollë.

- Eja këtu po të duash - i tha ajo , pa e vënë re tronditjen e thellë të tij.Iu duk pak provokuese të ulej aty.

Ndjeu atë zjarrmin e ngrohtë nga ashti gjer në palcë.Aq shume e dëshironte kur përhumbej në kaltërsinë e vështrimit të ëmbël.Sa e bukur.... sa fine... sa e brishtë....sikur sa ta prekje do kthehej në një flutur mbi një lule bore. Tërhoqi dorën e zgjatur për ta prekur...sa dëshironte ta puthte në ato buzët e mishta të një forme të rrumbullakosur në pjesën e sipërme e me cepat që ishin gati për të qeshur.Të prekte ato pjesë te hajthshme të trupit,sa fin po aq të rregullt.Ta bënte të provonte përkëdheljet e burrit që në çdo prekje të kishte nota tingulli në melodinë që këndohej në psherëtima kënaqësie.Të harronte plotësisht abuzimet e fatit te pamëshirshëm. Bobo , përsëri ngriti kokë forca e mbrojtjes e e epshit të një mashkulli. Dreqi ta hajë....me tjetër mendje hyri në dhomen e Eldës, të tjera ndjenja të papërmbajtura po e kaplonin.

- Kthehem shpejt, pas pak minutash , shpirt i shpirtit tim.Përpiqu të jesh e qetë ti të paktën. A ke besim tek unë?- Argjenti tërhoqi derën, për ta mbyllur plotësisht.Elda kish hedhur një mantel të kaltër e po e lidhte në belin e saj të hollë.

- Eja këtu po të duash - i tha ajo , pa e vënë re tronditjen e thellë të tij.Iu duk pak provokuese të ulej aty.

Ndjeu atë zjarrmin e ngrohtë nga ashti gjer në palcë.Aq shume e dëshironte kur përhumbej në kaltërsinë e vështrimit të ëmbël.Sa e bukur.... sa fine... sa e brishtë....sikur sa ta prekje do kthehej në një flutur mbi një lule bore. Tërhoqi dorën e zgjatur për ta prekur...sa dëshironte ta puthte në ato buzët e mishta të një forme të rrumbullakosur në pjesën e sipërme e me cepat që ishin gati për të qeshur.Të prekte ato pjesë te hajthshme të trupit,sa fin po aq të rregullt.Ta bënte të provonte përkëdheljet e burrit që në çdo prekje të kishte nota tingulli në melodinë që këndohej në psherëtima kënaqësie.Të harronte plotësisht abuzimet e fatit te pamëshirshëm. Bobo , përsëri ngriti kokë forca e mbrojtjes e e epshit të një mashkulli. Dreqi ta hajë....me tjetër mendje hyri në dhomen e Eldës, të tjera ndjenja të papërmbajtura po e kaplonin.

Elda ishte gati të jepej.E ndjeu, që të dy e dëshironin prej kohësh atë moment që po vinte si vetëtimë. Ishte hera e parë për të dy e dëshironin aq shumë... njëri tjetrin, por e hera e pare që tradhëtonin.

Mimoza vinte vërdallë nëpër dhomë duke shtërnguar me dy duar diçka që i rrihte në pjesën e sipërme të kokës...jo nuk i vinte nga tëmthat. Ato sikur i ishin fryrë e nuk pomponin nga presioni i gjakut të zemrës, që rrihte e çakorduar, e çmendur, e pa kontrolluar.

- Ç'me gjeti... mos po çmendem?

E izoluar brenda dhomës, i vinte t'i binte derës me shqelma e ta hapte.Minutat po i dukeshin orë. Po sikur të dilte? Po t'i kapte në flagrancë? Kjo që i erdhi në mendje e tërboi fare. Hapi me vrull perden ngjyre floriri të derës e doli ne ballkon.Iu duk sikur shpëtoi për një çast. Kish kaluar mesi i natës. Ishte një vezullim ndryshe sonte. Përsëri panselino.... hënë e plotë....Sa bukur dukej kopështi i tyre në këtë dritë hije të natyrshme.Asgjë s'pipëtinte.Nata sikur ruante qetësinë e dallëndysheve që flinin në folezën e ngritur prej tyre në cepat e tavanit bezhe të ballkonit.Mori frymë thellë e iu duk sikur gjithë qenija e saj u mblodh e u shtriq drejt qiellit plot yje vezullues, me një lutje.... O Zot ndihmomë!

Elda ishte gati të jepej.E ndjeu, që të dy e dëshironin prej kohësh atë moment që po vinte si vetëtimë. Ishte hera e parë për të dy e dëshironin aq shumë... njëri tjetrin, por e hera e pare që tradhëtonin.

Mimoza vinte vërdallë nëpër dhomë duke shtërnguar me dy duar diçka që i rrihte në pjesën e sipërme të kokës...jo nuk i vinte nga tëmthat. Ato sikur i ishin fryrë e nuk pomponin nga presioni i gjakut të zemrës, që rrihte e çakorduar, e çmendur, e pa kontrolluar.

- Ç'me gjeti... mos po çmendem?

E izoluar brenda dhomës, i vinte t'i binte derës me shqelma e ta hapte.Minutat po i dukeshin orë. Po sikur të dilte? Po t'i kapte në flagrancë? Kjo që i erdhi në mendje e tërboi fare. Hapi me vrull perden ngjyre floriri të derës e doli ne ballkon.Iu duk sikur shpëtoi për një çast. Kish kaluar mesi i natës. Ishte një vezullim ndryshe sonte. Përsëri panselino.... hënë e plotë....Sa bukur dukej kopështi i tyre në këtë dritë hije të natyrshme.Asgjë s'pipëtinte.Nata sikur ruante qetësinë e dallëndysheve që flinin në folezën e ngritur prej tyre në cepat e tavanit bezhe të ballkonit.Mori frymë thellë e iu duk sikur gjithë qenija e saj u mblodh e u shtriq drejt qiellit plot yje vezullues, me një lutje.... O Zot ndihmomë!

Kërkoi të dallonte sadopak lulet e çelura të mollës.Edhe ato ishin fshehur në errësirë mos dalloheshin nga kujtimi i natës së dasmës së tyre.

Iu kujtua derdhja e shampanjës, mes tingujve të muzikës klasike,miqtë çakërqejf që në pikun e haresë e gëzimit uronin..... Të trashëgoheni.... Të trashëgoheni....Eh....ajo pije shkumbëbardhë e shpërthyer që i kish lagur të dy.....

Të ndodhte sonte mrekullia....ta mbante atë shishe shampanje në dorë me kujdes se mos i krisej. Po sikur t'i thyhej? Pa dritën e ndezur të dhomës ku flinte Elda e i hynë të dridhura.I ftohti i natës po e sillte në vete.Ngriti kokën e pa yjet e ndezur që dridheshin në feksje bashkë me të.

- Mblidhe mendjen- i tha vetes.

Nuk është fundi i botës.Po fundi i qiellit tëlumturisë mos po venitej?

Elda ia hodhi të dyja duart në qafë , duke lodruar e tëra me një vështrim ndjellës, me lëkundje të lehta të trupit në finesë e elegancë.

- Argjent.....- i pëshpëriti në vesh e zgjatur me dëshirën e puthjes së ëmbël.

Kërkoi të dallonte sadopak lulet e çelura të mollës.Edhe ato ishin fshehur në errësirë mos dalloheshin nga kujtimi i natës së dasmës së tyre.

Iu kujtua derdhja e shampanjës, mes tingujve të muzikës klasike,miqtë çakërqejf që në pikun e haresë e gëzimit uronin..... Të trashëgoheni.... Të trashëgoheni....Eh....ajo pije shkumbëbardhë e shpërthyer që i kish lagur të dy.....

Të ndodhte sonte mrekullia....ta mbante atë shishe shampanje në dorë me kujdes se mos i krisej. Po sikur t'i thyhej? Pa dritën e ndezur të dhomës ku flinte Elda e i hynë të dridhura.I ftohti i natës po e sillte në vete.Ngriti kokën e pa yjet e ndezur që dridheshin në feksje bashkë me të.

- Mblidhe mendjen- i tha vetes.

Nuk është fundi i botës.Po fundi i qiellit tëlumturisë mos po venitej?

Elda ia hodhi të dyja duart në qafë , duke lodruar e tëra me një vështrim ndjellës, me lëkundje të lehta të trupit në finesë e elegancë.

- Argjent.....- i pëshpëriti në vesh e zgjatur me dëshirën e puthjes së ëmbël.

Ai i lëmoi flokët kaçurrela të verdha, që ishin derdhur mbi supet e drejta, në përdredhjen e fundit mbi mantelin e kaltër. E ëmbël si përplasja e shkumbëvalës së lehtë, që puthej me rërën në përthithjen e tejlagejes.

- Elda... te kam në zemër ty!

Ndjeu atë përflakjen që i vinte nga brenda kur ndjente aromën pranë trupit.

- Sonte jam e jotja.... plotësisht e jotja.

Psherëtima e zakonshme i mbeti mbi gjoksin e ngitur në përdëllimin e pritjes.

Ia mori kokën me dy duar e sikur po ndalte një fluturim në rrahje krahësh të kundërt me erën, që po frynte. Ndërkohë, që ajo priste flladin, ai po rrotullohej nga furia e një ere që duhej ta përballonte.

Përsëri ajo valë e nxehtë po i përshkonte gjithë qenijen. Si i çmendur kërkonte arsyetimin ta freskonte pak. Ah dyzimi! S' kishte më keq.Do të qëndronte gjatë? Elda ishte gati e lëshuar të hiqte mantelin.

-Shpirt....të dua.... sa të dëshiroj..!

Shtërngomë tëlutem!

- E dashur.... me ke hyrë në zemër, për atë, që të dua, për atë që, je.

Ai i lëmoi flokët kaçurrela të verdha, që ishin derdhur mbi supet e drejta, në përdredhjen e fundit mbi mantelin e kaltër. E ëmbël si përplasja e shkumbëvalës së lehtë, që puthej me rërën në përthithjen e tejlagejes.

- Elda... te kam në zemër ty!

Ndjeu atë përflakjen që i vinte nga brenda kur ndjente aromën pranë trupit.

- Sonte jam e jotja.... plotësisht e jotja.

Psherëtima e zakonshme i mbeti mbi gjoksin e ngitur në përdëllimin e pritjes.

Ia mori kokën me dy duar e sikur po ndalte një fluturim në rrahje krahësh të kundërt me erën, që po frynte. Ndërkohë, që ajo priste flladin, ai po rrotullohej nga furia e një ere që duhej ta përballonte.

Përsëri ajo valë e nxehtë po i përshkonte gjithë qenijen. Si i çmendur kërkonte arsyetimin ta freskonte pak. Ah dyzimi! S' kishte më keq.Do të qëndronte gjatë? Elda ishte gati e lëshuar të hiqte mantelin.

-Shpirt....të dua.... sa të dëshiroj..!

Shtërngomë tëlutem!

- E dashur.... me ke hyrë në zemër, për atë, që të dua, për atë që, je.

Dëshironte të zgjaste duart në atë pjesë të gjoksit të rrumbullakosur pak të zbuluar.Po dyzohej përsëri, përmes përflakjes së saj e përqëndrimit të tij.Deri ku ky dyzim, deri kur? Në cilën pjesë do fashitej?Asnjëherë s'e kish ndjerë veten në lëkundje të tilla.Ishte tip simpatik, pranonte shaka, ngacmonte e vetë,i bënte të tjerët të qeshnin me humorin e hollë! Të tjerët qeshnin më shumëpasi ai duke treguar qeshte vetë me lot.Se mos vetëm e simpatizonin vajzat?Ai mbas së bukurës bëhej erë. Po ç'e gjeti kështu?A mund të lindte një dashuri, mes dashurise së tij për Mimozën?Si ishte e mundur?Mos ia kishin mbushur mendjen vehtes para kohe, se ishin një trup, një mendje, një shpirt? Jo... jo, Mimoza i kishte të gjitha. I ishte dhënë me shpirt. Endërrat, pasioni, dëshirat e kishin marrë bekimin në prekje,në vështrimin brenda tyre e në puthjet me sytë mbyllur. Gjithçka kishte marrë formën e një mishërimi.Ishte lulja më e bukur, e freskët qe s'do vyshkej kurrë në shpirt.

- Elda dalim në ballkon?Është hënë e plotë. Qenka dritë sonte!Mori trikon e ia hodhi krahëve.

- Mos ftohesh... vishe! - Mirë bëre, po dridhem e tëra , mbase nga emocioni.

Dëshironte të zgjaste duart në atë pjesë të gjoksit të rrumbullakosur pak të zbuluar.Po dyzohej përsëri, përmes përflakjes së saj e përqëndrimit të tij.Deri ku ky dyzim, deri kur? Në cilën pjesë do fashitej?Asnjëherë s'e kish ndjerë veten në lëkundje të tilla.Ishte tip simpatik, pranonte shaka, ngacmonte e vetë,i bënte të tjerët të qeshnin me humorin e hollë! Të tjerët qeshnin më shumëpasi ai duke treguar qeshte vetë me lot.Se mos vetëm e simpatizonin vajzat?Ai mbas së bukurës bëhej erë. Po ç'e gjeti kështu?A mund të lindte një dashuri, mes dashurise së tij për Mimozën?Si ishte e mundur?Mos ia kishin mbushur mendjen vehtes para kohe, se ishin një trup, një mendje, një shpirt? Jo... jo, Mimoza i kishte të gjitha. I ishte dhënë me shpirt. Endërrat, pasioni, dëshirat e kishin marrë bekimin në prekje,në vështrimin brenda tyre e në puthjet me sytë mbyllur. Gjithçka kishte marrë formën e një mishërimi.Ishte lulja më e bukur, e freskët qe s'do vyshkej kurrë në shpirt.

- Elda dalim në ballkon?Është hënë e plotë. Qenka dritë sonte!Mori trikon e ia hodhi krahëve.

- Mos ftohesh... vishe! - Mirë bëre, po dridhem e tëra , mbase nga emocioni.

- Sa me pihet një cigare e i zgjati një. Ajo e vuri në buzë e s'e ndezi.

- Sikur aktron kur e thith- qeshi e priti,që ai ta ngacmonte po me ato fjalë.

Natë e vonë.... nuk frynte, asgje s'pipëtinte. Ajri i freskët merrte pak lagështirën e ciklave të ujit, që formonin shkumë të bardhë, mes rrathëve, që krijonte derdhja e ujit mbi pishinë. Presioni i currilave, që ndiqnin njëri tjetrin lart e më lart, rridhnin nga goja e asaj shtatore gruaje. Një skulpture në lakuriqësinë me duart e mbledhura,që fshihte diçka që s'duhej të dukej nga vetja. E lyer ndërmjet të kaltrës e blu , pikturuar në muret e saj të harkuara me dy delfine në kërcim, pishina dukej si një pjesë deti e shkëputur nga valëzimi i riciklimit te ujit te kulluar.Derdhja e vazhdueshme e ujit krijonte një tingull ... si për të kujtuar....si për të qenë zgjuar.

Dëgjuan këlthitjen e një kukuvajke, që i erdhi papritur! Po e ndiqnin me sy ku do qëndronte.
Mimoza u ngrit siç kishte rënë permbys, e donte përsëri të dilte të freskohej, e të mbushej me frymë në ballkon.U step. Përsëri mbuloi fytyrën me duar.Ishte mpirë e tëra. Mendimet ishin stakuar nga një hije e fortë dyshimi.

- Sa me pihet një cigare e i zgjati një. Ajo e vuri në buzë e s’e ndezi.

- Sikur aktron kur e thith- qeshi e priti,që ai ta ngacmonte po me ato fjalë.

Natë e vonë.... nuk frynte, asgje s’pipëtinte. Ajri i freskët merrte pak lagështirën e ciklave të ujit, që formonin shkumë të bardhë, mes rrathëve, që krijonte derdhja e ujit mbi pishinë. Presioni i currilave, që ndiqnin njëri tjetrin lart e më lart, rridhnin nga goja e asaj shtatore gruaje. Një skulpture në lakuriqësinë me duart e mbledhura,që fshihte diçka që s’duhej të dukej nga vetja. E lyer ndërmjet të kaltrës e blu , pikturuar në muret e saj të harkuara me dy delfine në kërcim, pishina dukej si një pjesë deti e shkëputur nga valëzimi i riciklimit te ujit te kulluar.Derdhja e vazhdueshme e ujit krijonte një tingull ... si për të kujtuar....si për të qenë zgjuar.

Dëgjuan këlthitjen e një kukuvajke, që i erdhi papritur! Po e ndiqnin me sy ku do qëndronte.
Mimoza u ngrit siç kishte rënë permbys, e donte përsëri të dilte të freskohej, e të mbushej me frymë në ballkon.U step. Përsëri mbuloi fytyrën me duar.Ishte mpirë e tëra. Mendimet ishin stakuar nga një hije e fortë dyshimi.

Sa e gjatë iu duk kjo natë! Akoma s'po zbardhej. Ndezi dritën. Mori një peshqir të vogël. Ktheu me fund ujin nga termusi , duke njomur buzët e thara, që i digjnin nga plasaritja.Inati ishte thurur brenda xhelozisë, në tiparet e mbërthyera.I erdhi nëpër mend tëshkallmonte derën,por kësaj rradhe t'i binte me shkelm derës së ballkonit.Ta shqyente dorezën, që për herë të parëpo merrte kuptimin e zmadhuar të funksionit.I vinte të çirrej në zë e t'i bërtiste sa fuqi që kishte.Ej ... ej mbaruat?Për mua ju të dy nuk ekzistoni! Mu zhdukuni që këtu! Jashtë... jashtë... në djall vafshit! Përse duhej të dënohej aq keq? Sepse i donte? Por jo sa të shfajësoheshin.U zmbraps nga dera me valën e dënesës. Mbuloi fytyrën me peshqirin e bardhe.Puthiti mire pëllëmbët mbi tënë mënyrë që mos e dëgjonin. Ngashërimat e thella vinin bashkë me zërin, akordat e të cilit për herë të parë i dëgjonte.Përsëri këlthitja e kukuvajkës... Kuku... ku.... tre herë. Ndaloi mbi degën e ullirit të vetëm të kopshtit, që ndodhej përballë dhomës së tij të gjumit.

- Atje... ja aty lart qëndroi kukuvajka, e shikon?

Argjenti pa dritën e dhomës ndezur e u rrënqeth i tëri.Mimoza... kushedi sa ishte lënduar! Sa i kishte gjykuar ata të dy?Ah

Sa e gjatë iu duk kjo natë! Akoma s'po zbardhej. Ndezi dritën. Mori një peshqir të vogël. Ktheu me fund ujin nga termusi , duke njomur buzët e thara, që i digjnin nga plasaritja.Inati ishte thurur brenda xhelozisë, në tiparet e mbërthyera.I erdhi nëpër mend tëshkallmonte derën,por kësaj rradhe t'i binte me shkelm derës së ballkonit.Ta shqyente dorezën, që për herë të parëpo merrte kuptimin e zmadhuar të funksionit.I vinte të çirrej në zë e t'i bërtiste sa fuqi që kishte.Ej ... ej mbaruat?Për mua ju të dy nuk ekzistoni! Mu zhdukuni që këtu! Jashtë... jashtë... në djall vafshit! Përse duhej të dënohej aq keq? Sepse i donte? Por jo sa të shfajësoheshin.U zmbraps nga dera me valën e dënesës. Mbuloi fytyrën me peshqirin e bardhe.Puthiti mire pëllëmbët mbi tënë mënyrë që mos e dëgjonin. Ngashërimat e thella vinin bashkë me zërin, akordat e të cilit për herë të parë i dëgjonte.Përsëri këlthitja e kukuvajkës... Kuku... ku.... tre herë. Ndaloi mbi degën e ullirit të vetëm të kopshtit, që ndodhej përballë dhomës së tij të gjumit.

- Atje... ja aty lart qëndroi kukuvajka, e shikon?

Argjenti pa dritën e dhomës ndezur e u rrënqeth i tëri.Mimoza... kushedi sa ishte lënduar! Sa i kishte gjykuar ata të dy?Ah

Mimoza e tij e pafajshme! Po Elda sa fajtore ishte në këtë histori dashurie të marrë? Jo , jo ai ndihej në faj për të dyja. Kur hynë brenda në dhome akoma i përkëdhelte flladi i freskët i natës përzier me aromën e luleve.

Elda lozonjare s'e kuptoi bllokimin e tij deri në një dhembje, që s'mund t'ia tregonte.

- Elda ..... duhet të tregohemi të arsyeshëm, me një mendje të ftohtë në dy trupa të bër valë.

- Ajo ngriu. Si ..... si thua Argjent? Përsërite dhe një herë i dashur?

Ia shtërngoi bluzën fort me dy duar, aty ku sapo mendonte t'ja ngrinte e të mbështetej në gjoksin e tij ....

- Mimoza është zgjuar akoma. Minutat i duken orë.Kushedi sa ka vuajtur! Ështe e ndjeshme, e çiltër, e zhgënjyer. Ndjehet keq, e tradhëtuar e në ndjenjë nga të dy njëkohësisht.

- Si.... si të ndjeu kur erdhe... Pse s' më the? Oh... oh.... më vjen keq për të... shumë keq! Kurse për ty, - e shtërngoi fort nga bluzja, duke e shkundur nga një fuqi e ardhur, që kërkonte shfajësim- Ti më çmend mua!

Fjalët e saj po binin në kundërshtim me egërsinë e veprimit.Ah, aq e ëmbël sa ishte! Përsëri po i dukej, se po e merrte një rrymë

Mimoza e tij e pafajshme! Po Elda sa fajtore ishte në këtë histori dashurie të marrë? Jo , jo ai ndihej në faj për të dyja. Kur hynë brenda në dhome akoma i përkëdhelte flladi i freskët i natës përzier me aromën e luleve.

Elda lozonjare s'e kuptoi bllokimin e tij deri në një dhembje, që s'mund t'ia tregonte.

- Elda ..... duhet të tregohemi të arsyeshëm, me një mendje të ftohtë në dy trupa të bër valë.

- Ajo ngriu. Si ..... si thua Argjent? Përsërite dhe një herë i dashur?

Ia shtërngoi bluzën fort me dy duar, aty ku sapo mendonte t'ja ngrinte e të mbështetej në gjoksin e tij ....

- Mimoza është zgjuar akoma. Minutat i duken orë.Kushedi sa ka vuajtur! Ështe e ndjeshme, e çiltër, e zhgënjyer. Ndjehet keq, e tradhëtuar e në ndjenjë nga të dy njëkohësisht.

- Si.... si të ndjeu kur erdhe... Pse s' më the? Oh... oh.... më vjen keq për të... shumë keq! Kurse për ty, - e shtërngoi fort nga bluzja, duke e shkundur nga një fuqi e ardhur, që kërkonte shfajësim- Ti më çmend mua!

Fjalët e saj po binin në kundërshtim me egërsinë e veprimit.Ah, aq e ëmbël sa ishte! Përsëri po i dukej, se po e merrte një rrymë

cikloni, nga përpara , e duhej të mbahej fort.Nuk ia hoqi duart, e la të shpërthente.

- Më ke dashur? Më do akoma? Ishte keqardhje nga të gjitha të pathënat nga çiltërsia e sat shoqeje?Ha ha ha mikes sime që, disa të fshehta nuk duhet t'i tregonte. Mos më deshet si imazh për pasionin tuaj?

-Elda.... mblidhe vehten!

- Cila kujton more se jam unë? Mund të jepesha kollaj për një mëshirë? Ju besova.... mbase çastet e abuzimit i dhane rrugë ndjenjave që, nuk më pyetën mua.

Lotët filluan t'i rridhnin e po ndjente njëkohësisht dhembjet e trupit në ngashërime shpirti. Ai ndjeu që po e mëshironte deri në pikën e fundit.Kur po i lëmonte flokët për ta qetësuar, Elda ia hoqi dorën që ishte akull e ftohtë.

- Lermë mua....jam mësuar të vuajë.... qetësoje Mozën.... i thuaj se e çmoj... e dua.- Fli zemër e mirë... është vonë... erdhe e cfilitur e mua po më copëtohet shpirti. Më fal Elda. Mos qaj zemër.Po të kishim ndjekur epshet tona do ishim vetëm për një natë.Ti do të jesh përherë melodia më e dhimbshme, e ëmbël, por shume e shtrenjte, në thellësi të fshehtë tëshpirtit tim.

cikloni, nga përpara , e duhej të mbahej fort.Nuk ia hoqi duart, e la të shpërthente.

- Më ke dashur? Më do akoma? Ishte keqardhje nga të gjitha të pathënat nga çiltërsia e sat shoqeje?Ha ha ha mikes sime që, disa të fshehta nuk duhet t'i tregonte. Mos më deshet si imazh për pasionin tuaj?

-Elda.... mblidhe vehten!

- Cila kujton more se jam unë? Mund të jepesha kollaj për një mëshirë? Ju besova.... mbase çastet e abuzimit i dhane rrugë ndjenjave që, nuk më pyetën mua.

Lotët filluan t'i rridhnin e po ndjente njëkohësisht dhembjet e trupit në ngashërime shpirti. Ai ndjeu që po e mëshironte deri në pikën e fundit.Kur po i lëmonte flokët për ta qetësuar, Elda ia hoqi dorën që ishte akull e ftohtë.

- Lermë mua....jam mësuar të vuajë.... qetësoje Mozën.... i thuaj se e çmoj... e dua.- Fli zemër e mirë... është vonë... erdhe e cfilitur e mua po më copëtohet shpirti. Më fal Elda. Mos qaj zemër.Po të kishim ndjekur epshet tona do ishim vetëm për një natë.Ti do të jesh përherë melodia më e dhimbshme, e ëmbël, por shume e shtrenjte, në thellësi të fshehtë tëshpirtit tim.

E puthi lehtë në dorën e lëshuar , e u largua. Donte të ndizte një cigare! Të qetësohej disi, por shpejtoi hapat te Mimoza.

- Shpirt të më falësh! Të na falësh të dy. Sa shumë që të ndjej....se të kam vetëm ty! Ajo po depërtonte thellë në sytë e tij.Afrohu, mbështetu ne krahun tim e ia mori kokën në gjoks.Shpirt i vogël, si të bëra të vuash .... të kam engjëll unë.....A mund të shkelja mbi dashurinë tënde? Vallë lëndohej një paqe e plotë? Jo as unë, as Elda.

- Përse? - i mbeti pyetja padashje jashtë fjalës.

- Dua të them që, çdo burre do të tundohej para bukurisë së magjishme të një gruaje.Por a ka grua, me ndjeshmërinë e feminilitetit , brenda të cilit është një botë e bukur, plot finesë e shije, të mos thyhet , sado i fortë të jetë karakteri i saj?

- Është Elda?- pyeti Mimoza, jo për kuriozitetin e xhelozisë, tashmë të lodhur.

- Jo, as ajo, as ti.Çdo grua po s’u plotësua në botën e bukur te ndjenjave, po s’ e deshe si veten, të kujdesesh deri në lirinë e plotë të fjalës e mendimit, mund të rrëshqasë. Gratë e lira nuk tradhëtojne.Unë të dua më shumë se veten, që

E puthi lehtë në dorën e lëshuar , e u largua. Donte të ndizte një cigare! Të qetësohej disi, por shpejtoi hapat te Mimoza.

- Shpirt të më falësh! Të na falësh të dy. Sa shumë që të ndjej....se të kam vetëm ty! Ajo po depërtonte thellë në sytë e tij.Afrohu, mbështetu ne krahun tim e ia mori kokën në gjoks.Shpirt i vogël, si të bëra të vuash .... të kam engjëll unë.....A mund të shkelja mbi dashurinë tënde? Vallë lëndohej një paqe e plotë? Jo as unë, as Elda.

- Përse? - i mbeti pyetja padashje jashtë fjalës.

- Dua të them që, çdo burre do të tundohej para bukurisë së magjishme të një gruaje.Por a ka grua, me ndjeshmërinë e feminilitetit , brenda të cilit është një botë e bukur, plot finesë e shije, të mos thyhet , sado i fortë të jetë karakteri i saj?

- Është Elda?- pyeti Mimoza, jo për kuriozitetin e xhelozisë, tashmë të lodhur.

- Jo, as ajo, as ti.Çdo grua po s'u plotësua në botën e bukur te ndjenjave, po s' e deshe si veten, të kujdesesh deri në lirinë e plotë të fjalës e mendimit, mund të rrëshqasë. Gratë e lira nuk tradhëtojne.Unë të dua më shumë se veten, që

të jesh e imja , vetëm e imja..... përtej përjetësisë.

Fjetën pak orë të përqafuar ashtu, por të kapitur në një gjumë të thellë.Mimoza u ngrit ngadalë, mos zgjonte Argjentin.E shikonte e s' ngopej me hijeshinë e burrit plot nur e dritë.Pasi bëri një tualet të lehtë që, mos dukej aq e zbehtë e në sy të Eldës, veshi rrobdizhanin e bardhë prej atlasi me shkëlqim të lehtë të bardhë.

I shkonte e i rrinte bukur kur e lidhte rreth belit të hollë.Flokët e drejtë, të zgjatura me peshën në fund, të zeza pak në të thyer, i derdheshin mbi supe, deri në mesin e shpatullave.Ishte shume tërheqëse me vështrimin e çiltër në sytë e zinj , poshtë vetullave të harkuara, me qerpikët e zgjatur, po aq të zinj, në atë lëmesë të lekurës tejet të bardhë të fytyrës. Shpresonte të zgjohej e Elda para tij, mbase në një farë mënyre e ruanin pak miqësine që kishte pësuar një krisje të ftohtë.

Dhoma e Eldës ishte rregulluar e ishte hapur përgjysmë dera e ballkonit.Valixhja nuk ishte në dhomë. Nxitoi në ballkon. S'ishte aty. Shpejtoi jashtë ne oborr. Shpresoi ta gjente ne kopësht. As atje. U shqetësua e po i merrej fryma. Mos ishte treguar egoiste? Përse s'ishte ngritur më herët? Mbi tavolinën drejtkëndëshe të rregullt

të jesh e imja , vetëm e imja..... përtej përjetësisë.

Fjetën pak orë të përqafuar ashtu, por të kapitur në një gjumë të thellë.Mimoza u ngrit ngadalë, mos zgjonte Argjentin.E shikonte e s’ ngopej me hijeshinë e burrit plot nur e dritë.Pasi bëri një tualet të lehtë që, mos dukej aq e zbehtë e në sy të Eldës, veshi rrobdizhanin e bardhë prej atlasi me shkëlqim të lehtë të bardhë.

I shkonte e i rrinte bukur kur e lidhte rreth belit të hollë.Flokët e drejtë, të zgjatura me peshën në fund, të zeza pak në të thyer, i derdheshin mbi supe, deri në mesin e shpatullave.Ishte shume tërheqëse me vështrimin e çiltër në sytë e zinj , poshtë vetullave të harkuara, me qerpikët e zgjatur, po aq të zinj, në atë lëmesë të lekurës tejet të bardhë të fytyrës. Shpresonte të zgjohej e Elda para tij, mbase në një farë mënyre e ruanin pak miqësine që kishte pësuar një krisje të ftohtë.

Dhoma e Eldës ishte rregulluar e ishte hapur përgjysmë dera e ballkonit.Valixhja nuk ishte në dhomë. Nxitoi në ballkon. S’ishte aty. Shpejtoi jashtë ne oborr. Shpresoi ta gjente ne kopësht. As atje. U shqetësua e po i merrej fryma. Mos ishte treguar egoiste? Përse s’ishte ngritur më herët? Mbi tavolinën drejtkëndëshe të rregullt

me fibër të bardhë gjeti një letër. E lexoi menjëherë duke iu dridhur duart. *"Të shtrenjttt e mi, Mimoza e Argjent! Ju kërkoj falje.Largohem përgjithmone në qytetin e lindjes.Ishte një rrëshqitje në fluturim, në mes të dy dashurive. Lumturi të përjetshme! LAMTUMIRË!"*

Iu shtrydh zemra.U mbështet në parvazin e ballkonit , me sytë e përlotur duke u përhumbur në bukurinë magjepsëse të lindjes së diellit.Elda... ah ...Elda! Sa shumë e tërhiqte lindja e diellit.

Qeshnin ndonjëherë të dyja, pasi Mimozën e tërhiqte më shumë përflakja e perëndimit të tij. Buzë Jonit është një mrekulli perëndimi i diellit tënd Mimozë... U përlot përsëri me kujtimin e dhimbsur e të dashur të saj...Ndjeu Argjentin që i hodhi dorën në qafën e hollë e ta përkëdhelte me mollëzat e gishtërinjve aty ku i pëlqente. E ktheu nga vetja. Sa e pa përlotjen e syve në një shkëlqim që mund të derdhej, kuptoi gjithçka. Mbase do mbetej një melodi kujtimi që do bënin sikur nuk do ta dëgjonin.

*FUND*

*Angli!*
*25-11-2018*
*Zoica Gjolla Popi*

me fibër të bardhë gjeti një letër. E lexoi menjëherë duke iu dridhur duart. *"Të shtrenjttt e mi, Mimoza e Argjent! Ju kërkoj falje.Largohem përgjithmone në qytetin e lindjes.Ishte një rrëshqitje në fluturim, në mes të dy dashurive. Lumturi të përjetshme! LAMTUMIRË!"*

Iu shtrydh zemra.U mbështet në parvazin e ballkonit , me sytë e përlotur duke u përhumbur në bukurinë magjepsëse të lindjes së diellit.Elda... ah ...Elda! Sa shumë e tërhiqte lindja e diellit.

Qeshnin ndonjëherë të dyja, pasi Mimozën e tërhiqte më shumë përflakja e perëndimit të tij. Buzë Jonit është një mrekulli perëndimi i diellit tënd Mimozë... U përlot përsëri me kujtimin e dhimbsur e të dashur të saj...Ndjeu Argjentin që i hodhi dorën në qafën e hollë e ta përkëdhelte me mollëzat e gishtërinjve aty ku i pëlqente. E ktheu nga vetja. Sa e pa përlotjen e syve në një shkëlqim që mund të derdhej, kuptoi gjithçka. Mbase do mbetej një melodi kujtimi që do bënin sikur nuk do ta dëgjonin.

*FUND*

*Angli!*
*25-11-2018*
*Zoica Gjolla Popi*

## Shëtitje me Luisin

**Mirëmbrëma! Luith jam!**

- Eja të dalim shpejt da da - më tha nëna një ditë.

A e dini përse? Deas, motrës time ja bllokoj ekranin e televizorit që është i madh në dhomën e pritjes.Më pëlqen shumë kjo loje e e përsëris disa herë.

- Largohu me të mirë që andej- bërtet ajo me të madhe qysh ne fillim.

Sa zërin e lartë e ka! Herën e fundit më shpëton nëna. Pale ai Adami i ka prerë kaçurrelat e është bërë një tullac shume i lezeçëm. E dini ju si i ka bërë makinat e mia te voglat? S' kupton hiç trazovaçi. Edhe lodrat e veta s'po këndojnë e flasin se po ia heq bateritë.Une e dua shumë e më merr malli orët që jam në kopësht. E shtërngoj fort fort aq sa ai qan me të madhe. Po çfarë ka me mua?

- Shpejt të dalim nga shtëpia- tha nëna e mori çantat e përgatitura për shëtitje.

-Po panolinën e ke vënë?

Jo për gjë, por njërën e tregoj e tjetrën jo!

- Ta kesh për siguri se ti tani je i madh- tha nëna e shpejtonte se ata të dy nuk pushonin. Morëm rrugën për tek parku i Madh i qytetit.

**Shëtitje me Luisin**

**Mirëmbrëma! Luith jam!**

- Eja të dalim shpejt da da - më tha nëna një ditë.

A e dini përse? Deas, motrës time ja bllokoj ekranin e televizorit që është i madh në dhomën e pritjes.Më pëlqen shumë kjo loje e e përsëris disa herë.

- Largohu me të mirë që andej- bërtet ajo me të madhe qysh ne fillim.

Sa zërin e lartë e ka! Herën e fundit më shpëton nëna. Pale ai Adami i ka prerë kaçurrelat e është bërë një tullac shume i lezeçëm. E dini ju si i ka bërë makinat e mia te voglat? S' kupton hiç trazovaçi. Edhe lodrat e veta s'po këndojnë e flasin se po ia heq bateritë.Une e dua shumë e më merr malli orët që jam në kopësht. E shtërngoj fort fort aq sa ai qan me të madhe. Po çfarë ka me mua?

- Shpejt të dalim nga shtëpia- tha nëna e mori çantat e përgatitura për shëtitje.

-Po panolinën e ke vënë?

Jo për gjë, por njërën e tregoj e tjetrën jo!

- Ta kesh për siguri se ti tani je i madh- tha nëna e shpejtonte se ata të dy nuk pushonin. Morëm rrugën për tek parku i Madh i qytetit.

- Nëna pije ti xhusin se nuk e dua. E piu e shkreta kushedi kishte etje.Sapo po afroheshim tek ura e parë me dërrasa mua sikur më njohin pëllumbat, mak maku ose daki i them unë për kollaj, pasi ato afrohen vetë. Sa të mençur që janë! E dinë që unë marr bukë me vete. Sapo e nxorra ato pëllumbat e bardhë e disa gri sa s'po me hipnin në kokë. E dini sa u tremba? Dolën e dakit e vogla nga uji e mak ... mak kush të hante më përpara.

E dini sa pemë të larta ka këtu e buzë lumit? Po ketrat si hipin gjer në majë duke kërcyer. Sa të lezeçëm që janë! Të vegjël e të mëdhenj tundin bishtin e gjatë e se si i ngrihet në një formë shumë të bukur.

- Ikim andej-i thashë nënës i vendosur.

Doja ta haja vetë bukën e shijshme thatë. Po pse më shijon aq shumë? Më dha nëna një copë të madhe.

-Nëna haji ti ato gjërat e mija se nuk i dua. E ku ma prish nëna mua aq sa filloi t’i hante me oreks.

Dhe pse ishte ftohtë. kishte plot xhaxhi e teta me fëmijë.

Disa kishin marrë për shetitje dogun e vogël me kordhele e me një jelek të bukur mbi shpinë, kurse qentë e mëdhenj i mbanin me zinxhir të

- Nëna pije ti xhusin se nuk e dua. E piu e shkreta kushedi kishte etje.Sapo po afroheshim tek ura e parë me dërrasa mua sikur më njohin pëllumbat, mak maku ose daki i them unë për kollaj, pasi ato afrohen vetë. Sa të mençur që janë! E dinë që unë marr bukë me vete. Sapo e nxorra ato pëllumbat e bardhë e disa gri sa s'po me hipnin në kokë. E dini sa u tremba? Dolën e dakit e vogla nga uji e mak ... mak kush të hante më përpara.

E dini sa pemë të larta ka këtu e buzë lumit? Po ketrat si hipin gjer në majë duke kërcyer. Sa të lezeçëm që janë! Të vegjël e të mëdhenj tundin bishtin e gjatë e se si i ngrihet në një formë shumë të bukur.

- Ikim andej-i thashë nënës i vendosur.

Doja ta haja vetë bukën e shijshme thatë. Po pse më shijon aq shumë? Më dha nëna një copë të madhe.

-Nëna haji ti ato gjërat e mija se nuk i dua. E ku ma prish nëna mua aq sa filloi t’i hante me oreks.

Dhe pse ishte ftohtë. kishte plot xhaxhi e teta me fëmijë.

Disa kishin marrë për shetitje dogun e vogël me kordhele e me një jelek të bukur mbi shpinë, kurse qentë e mëdhenj i mbanin me zinxhir të

trashë e diçka ose top të vogël në gojë për të qenë të sigurtë. Une ato të vegjëlit i përkëdhel po ato të mëdhenjtë i kam shumë frikë.

- Shko tek xhaxhi heroi të bëj një foto! Une po i vija vërdallë e vrapova e te obelisku ku janë shkruar emrat e shokëve të tij. Herën tjetër nuk mund të vinim dot deri këtu. Sa shumë njerëz që kishte! Të veshur si për festë me buqeta lulesh në dorë e me stema lulekuqesh në rroba të mëdhenj e të vegjël nën ritmin e muzikës së bandës frymore drejtoheshin tek xhaxhi Heroi!
Po sa kam qeshur me nënën kur po e bija vërdallë. Bëra sikur këputa lulet tek obelisku.

- Mos mos - më foli nëna.

Por ato ishin të prera si prej vërteti në formë petalesh prej llamarine lyer me bojë të kuqe e në formën e kurorës.

-Mos i këput lulet! Une i shkathët si Adami nuk jam por për të vrapuar ajo s' më kap dot. Kur u afrua t'i përkëdhelte lulet e kuptoi pse qeshja unë me të madhe. Po mbase një here në vit e kanë ditëlindjet këto heronjtë.

- Nëna dua prapë bukë!

- Ha te keqen nëna- e ha nëna për vete.

trashë e diçka ose top të vogël në gojë për të qenë të sigurtë. Une ato të vegjëlit i përkëdhel po ato të mëdhenjtë i kam shumë frikë.

- Shko tek xhaxhi heroi të bëj një foto! Une po i vija vërdallë e vrapova e te obelisku ku janë shkruar emrat e shokëve të tij. Herën tjetër nuk mund të vinim dot deri këtu. Sa shumë njerëz që kishte! Të veshur si për festë me buqeta lulesh në dorë e me stema lulekuqesh në rroba të mëdhenj e të vegjël nën ritmin e muzikës së bandës frymore drejtoheshin tek xhaxhi Heroi!
Po sa kam qeshur me nënën kur po e bija vërdallë. Bëra sikur këputa lulet tek obelisku.

- Mos mos - më foli nëna.

Por ato ishin të prera si prej vërteti në formë petalesh prej llamarine lyer me bojë të kuqe e në formën e kurorës.

-Mos i këput lulet! Une i shkathët si Adami nuk jam por për të vrapuar ajo s' më kap dot. Kur u afrua t'i përkëdhelte lulet e kuptoi pse qeshja unë me të madhe. Po mbase një here në vit e kanë ditëlindjet këto heronjtë.

- Nëna dua prapë bukë!

- Ha te keqen nëna- e ha nëna për vete.

Apo s’i kishte ardhë rralla e frutave që i pëlqejne aq shumë. I hante me kujdes kur s' kalonin njerëz.Duke vrapuar pas ketrave gjeta një shkop.

Po sa frikë e paskan shkopin! Ketrat u ngjitën shumë lart e u tkurrën nëpër pemë.

- Luis hidhe shkopin!Shkopinj ka plot por asnjë nga fëmijët nuk i mban në dorë!

Une si i urtë që jam me herën e parë bëj sikur s'dëgjoj.M’u kujtua kur po i tregonte gjyshi nënës se një shok pune grek shumë i mirë që punonin bashkë kur këmbëngulte gjyshi i thonte që ti ke kokë arnauti.

Para se të ngjitesh tek ura tjetër e harkuar nëpërmjet disa shkallëve mund të zbresësh pranë lumit ku lahej mjelma e rrethuar nga daki mak maku të vogla.

Një teta kishte dy vajza sa unë por që ngjanin shumë me njëra tjetrën e të veshura njësoj. E flokët të kapur të dy bishtalecat me fjongo ngjyrë rozë. Filluan të ushqenin rosat.Unë i bëja copat e vogla fare. Aq u gëzova kur erdhi një xhaxhi me kapelë e çizme sikur kishte dalë për gjah si unë. Nxorri nga çanta plot rriska buke e po i ushqente të gjithë që ju afruan. Si duket e njihnin se Mjelma herë e zhyste kokën në uje e herë e nxirrte. Nga gëzimi

Apo s’i kishte ardhë rralla e frutave që i pëlqejne aq shumë. I hante me kujdes kur s' kalonin njerëz.Duke vrapuar pas ketrave gjeta një shkop.

Po sa frikë e paskan shkopin! Ketrat u ngjitën shumë lart e u tkurrën nëpër pemë.

- Luis hidhe shkopin!Shkopinj ka plot por asnjë nga fëmijët nuk i mban në dorë!

Une si i urtë që jam me herën e parë bëj sikur s'dëgjoj.M’u kujtua kur po i tregonte gjyshi nënës se një shok pune grek shumë i mirë që punonin bashkë kur këmbëngulte gjyshi i thonte që ti ke kokë arnauti.

Para se të ngjitesh tek ura tjetër e harkuar nëpërmjet disa shkallëve mund të zbresësh pranë lumit ku lahej mjelma e rrethuar nga daki mak maku të vogla.

Një teta kishte dy vajza sa unë por që ngjanin shumë me njëra tjetrën e të veshura njësoj. E flokët të kapur të dy bishtalecat me fjongo ngjyrë rozë. Filluan të ushqenin rosat.Unë i bëja copat e vogla fare. Aq u gëzova kur erdhi një xhaxhi me kapelë e çizme sikur kishte dalë për gjah si unë. Nxorri nga çanta plot rriska buke e po i ushqente të gjithë që ju afruan. Si duket e njihnin se Mjelma herë e zhyste kokën në uje e herë e nxirrte. Nga gëzimi

i rashë me shkop disa gjetheve peta-shuqe të mëdhaja e të gjelbra.

- Mos i godit gjethet se qajnë!

E me të vërtetë ishin të lagura.

- Po këto qajnë gjithmonë moj nëna se këtu bie shumë shi.

-Jo Luis shiu i pastron e i shkëlqen.Qajnë kur dikush i godet me shkop.

M’u mbushën sytë me lot se më erdhi keq por kur m’u kujtua se i ngjaj gjyshit tim si kokë arnauti e shtërngova mirë shkopin që të mos më binte nga dora.Kisha dëshirë ta çoja në shtëpi të më shihte Dea e Adami të armatosur! T’i tregoja e gjyshit se kisha kokë arnauti.

U lodhëm pak me nënën por e u kënaqem. Nëna u ngop me ushqimet e mija, ndërsa unë do i shpëtoja supës së pasur me mish ose peshk. Sikur s' mjaftojnë perimet e shumta por duhet e avokado qe gjoja i jep shije të mire! Harrova t'ju them se ajo teta që na mat e na peshon ka thënë se unë jam një në njëqind djemtë më të gjatë se moshatarët e mi këtu në Angli! Me siguri që e ato që janë si une shkojnë me nënën e tyre tek parku.

Kot nuk thonë ha buke thatë që të bëhesh i gjatë.

i rashë me shkop disa gjetheve peta-shuqe të mëdhaja e të gjelbra.

- Mos i godit gjethet se qajnë!

E me të vërtetë ishin të lagura.

- Po këto qajnë gjithmonë moj nëna se këtu bie shumë shi.

-Jo Luis shiu i pastron e i shkëlqen.Qajnë kur dikush i godet me shkop.

M’u mbushën sytë me lot se më erdhi keq por kur m’u kujtua se i ngjaj gjyshit tim si kokë arnauti e shtërngova mirë shkopin që të mos më binte nga dora.Kisha dëshirë ta çoja në shtëpi të më shihte Dea e Adami të armatosur! T’i tregoja e gjyshit se kisha kokë arnauti.

U lodhëm pak me nënën por e u kënaqem. Nëna u ngop me ushqimet e mija, ndërsa unë do i shpëtoja supës së pasur me mish ose peshk. Sikur s' mjaftojnë perimet e shumta por duhet e avokado qe gjoja i jep shije të mire! Harrova t'ju them se ajo teta që na mat e na peshon ka thënë se unë jam një në njëqind djemtë më të gjatë se moshatarët e mi këtu në Angli! Me siguri që e ato që janë si une shkojnë me nënën e tyre tek parku.

Kot nuk thonë ha buke thatë që të bëhesh i gjatë.

Por kam hall se a më shkurtohet nëna ime! Te gjithëve ju dua fort! Ndonjëherë mund t' ju tregoj e ndonje sekret se i vogël jam akoma.

Por kam hall se a më shkurtohet nëna ime! Te gjithëve ju dua fort! Ndonjëherë mund t' ju tregoj e ndonje sekret se i vogël jam akoma.

## Në Rrjedhën E Lumit

- Ti e ke fajin nënë!

Klea duke kërkuar nëpër xhepa nxorri astarin e tyre nga jashtë si për të dëshmuar qe s'e kish gjetur atë që i duhej.

- Përse jam fajtore? - e pyeta e hutuar.

- Kam harruar celularin. Ti e dije që ishte e para gjë që duhet të më kujtoje. Por jo e ke mendjen tek ushqimet. Asgjë s' kam për të vënë në gojë - mblodhi ato buzët e kuqe e me formë pak të harkuar në pjesën e sipërme, mblodhiduart në gjoks si për ta shfaqur mirë rebelizmin e saj. U pamë drejt në sy që të kuptoheshim pa fjalë. Shikimi i saj ishte hakërryes,depërtues nga dy sy tëzinj, me qerpikë po aq të zinj, të dendur, të gjatë , të përthyer në majat e tyre që nxirrnin në pah retinën me shkëlqimin e lotit.

- Pa më thuaj ku ta di vendin e takimit me shokët e shoqet?Parku është i madh e sikur të kërkojmë, s'do t'i gjejmë.

Kisha marrë me vehte Mirkon, nipin tjetër që ishte nëntë vjeç e tre vite më i vogël se Klea. Ish nga ditët e rralla nordike ku qielli ish pa re, i kaltër e i kthjellët duke i lënë rrezet e diellit të

## Në Rrjedhën E Lumit

- Ti e ke fajin nënë!

Klea duke kërkuar nëpër xhepa nxorri astarin e tyre nga jashtë si për të dëshmuar qe s'e kish gjetur atë që i duhej.

- Përse jam fajtore? - e pyeta e hutuar.

- Kam harruar celularin. Ti e dije që ishte e para gjë që duhet të më kujtoje. Por jo e ke mendjen tek ushqimet. Asgjë s' kam për të vënë në gojë - mblodhi ato buzët e kuqe e me formë pak të harkuar në pjesën e sipërme, mblodhiduart në gjoks si për ta shfaqur mirë rebelizmin e saj. U pamë drejt në sy që të kuptoheshim pa fjalë. Shikimi i saj ishte hakërryes,depërtues nga dy sy tëzinj, me qerpikë po aq të zinj, të dendur, të gjatë , të përthyer në majat e tyre që nxirrnin në pah retinën me shkëlqimin e lotit.

- Pa më thuaj ku ta di vendin e takimit me shokët e shoqet?Parku është i madh e sikur të kërkojmë, s'do t'i gjejmë.

Kisha marrë me vehte Mirkon, nipin tjetër që ishte nëntë vjeç e tre vite më i vogël se Klea. Ish nga ditët e rralla nordike ku qielli ish pa re, i kaltër e i kthjellët duke i lënë rrezet e diellit të

shpërthenin lirshëm. Në ditët e tjera retë dendësoheshin aq shumë poshtë tij si një shtroje e padepërtueshme e kryeneçe.

Ngrohtësinë e rrezeve të diellit e ndjeja nëshpatulla e më dukej sikur përkëdhelnin shpirtin tim që kish filluar të dridhej lehtë.

- Mos u mërzit zemër e po nuk i takuam do ta kalojmë shume bukur bashkë.Këtë park s'e kemi eksploruar e do kemi plot surpriza.

- Si the nënë? Përsërite e një herë? Mirko më rrëmbeu njërën çantë nga dora e me dorën tjetër shtërngonte topin e tij ngjyrë qumështi me disa ndarje me viza të zeza ku shkruhej nga firma se ish i kampionatit botëror tëvitit 2016.

- Mos vazhdo ta fajësosh nënën për gabimin tënd!

- Po e ka zakon ajo të luajë rolin e gjynafisë.Mirë që s'po fillon me zë ato uf bufet e veta.

- Mos i fol nënës time kështu! S'është vetëm e jotja , është e nëna ime.

- Për inatin tënd nëna jeton me mua e ndonjëherë fle ne dhomën time. Plas tani nga inati! S'e kisha të lehtë.

shpërthenin lirshëm. Në ditët e tjera retë dendësoheshin aq shumë poshtë tij si një shtroje e padepërtueshme e kryeneçe.

Ngrohtësinë e rrezeve të diellit e ndjeja nëshpatulla e më dukej sikur përkëdhelnin shpirtin tim që kish filluar të dridhej lehtë.

- Mos u mërzit zemër e po nuk i takuam do ta kalojmë shume bukur bashkë.Këtë park s'e kemi eksploruar e do kemi plot surpriza.

- Si the nënë? Përsërite e një herë? Mirko më rrëmbeu njërën çantë nga dora e me dorën tjetër shtërngonte topin e tij ngjyrë qumështi me disa ndarje me viza të zeza ku shkruhej nga firma se ish i kampionatit botëror tëvitit 2016.

- Mos vazhdo ta fajësosh nënën për gabimin tënd!

- Po e ka zakon ajo të luajë rolin e gjynafisë.Mirë që s'po fillon me zë ato uf bufet e veta.

- Mos i fol nënës time kështu! S'është vetëm e jotja , është e nëna ime.

- Për inatin tënd nëna jeton me mua e ndonjëherë fle ne dhomën time. Plas tani nga inati! S'e kisha të lehtë.

- Nënë, ke do ti më shumë? Mua apo Mirkon? Mos thuaj që na do njësoj, se njerëzit s'janë njësoj e dashuritë janë të ndryshme.

Drejtova dorën e gjyshes, hapa gishtërinjtë që mezi më bindeshin e me zërin që hera herës mezi dilte, i thashë:

- Sa gishta ka kjo dorë?

- Pesë gishta ka - thanë të dy të çuditur njëzëri.

- Cilindo të presesh prej tyre, dhembin njësoj, prandaj nëna ju do të dy njësoj.

Mirko u prek duke humbur në imagjinatën e tij e s'u ndje më.

Sapo kaluam urën e lartë në formë tuneli, para syve tanë u shfaq një fushë e gjerë ku akoma ndjehej aroma e barit të korrur ditë më parë në mënyrë të njëtrajtshme duke pranuar lehtshëm mbirjen e barit të ri duke i dhënë këi hapësire ngjyrën e blertë anembanë.Njëra nga rrugicat e ngushta të asfaltuara rrethonte parkun tej e tej ,ndërsa dy te tjera dredhonin pjerrtasi.Vetëm pas kalimit të urës gjendeshin pemë të larta me dy, tre  kurora të formuara nga degë që zgjatnin krahët me kërcenjë si gishta të hollë,të përdredhura ku mezi shqiteshin nga njëri tjetri.Ajri i pastër me oksigjen t'i mbushte mushkëritë me një freski,që të sillte njëndjesi të

- Nënë, ke do ti më shumë? Mua apo Mirkon? Mos thuaj që na do njësoj, se njerëzit s'janë njësoj e dashuritë janë të ndryshme.

Drejtova dorën e gjyshes, hapa gishtërinjtë që mezi më bindeshin e me zërin që hera herës mezi dilte, i thashë:

- Sa gishta ka kjo dorë?

- Pesë gishta ka - thanë të dy të çuditur njëzëri.

- Cilindo të presesh prej tyre, dhembin njësoj, prandaj nëna ju do të dy njësoj.

Mirko u prek duke humbur në imagjinatën e tij e s'u ndje më.

Sapo kaluam urën e lartë në formë tuneli, para syve tanë u shfaq një fushë e gjerë ku akoma ndjehej aroma e barit të korrur ditë më parë në mënyrë të njëtrajtshme duke pranuar lehtshëm mbirjen e barit të ri duke i dhënë kësaj hapësire ngjyrën e blertë anembanë.Njëra nga rrugicat e ngushta të asfaltuara rrethonte parkun tej e tej ,ndërsa dy te tjera dredhonin pjerrtasi.Vetëm pas kalimit të urës gjendeshin pemë të larta me dy, tre kurora të formuara nga degë që zgjatnin krahët me kërcenjë si gishta të hollë,të përdredhura ku mezi shqiteshin nga njëri tjetri.Ajri i pastër me oksigjen t'i mbushte mushkëritë me një freski,që të sillte njëndjesi të

çuditshme.Zogjtë cicëronin me rradhë,sikur i përgjigjeshin nga larg e lart njeri tjetrit me gjuhën e tyre.

Mahniteshe kur dëgjoje gurgullimën e ujit,si një ujvarë e vogël në hyrjet e urës,që formohej nga një digë e pjerrët.Stërkalat nga uji i shkumbëzuar mbas rrëmbesës përfundonin ne rrathë flluskash që plluskonin e shuheshin gjatë grykës e gjer në një rrjedhje të qetë. Klea ngriti pak kapelën e po mbante kasketën e saj në njërin cep.Ndërsa ajo kërkonte në hapsirë ndonje grup shokësh e shoqesh,unë vështroja flokët e saj te dallgëzuara ngjyrë gështenje,që e binin mbi supat e rrumb-ullakosura.Një kaçurrel i përdredhur i binte mbi ballin e bukur e nga bardhësia e lëkurës së lëmuar,ai merrte nuancën gështenjë të errët e sikur lodronte kur ajo kthente kokën sa andej këtej.Bukuria e saj në këtë qytet nordik po binte në sy.Kur ajo kalonte me atë të ecurëën e saj elegante e të veçantë, kalimtarët kthenin kokën e i buzëqeshnin.

Sa po gjente një shteg të hapur pak, ajo ecte duke larguar me dorë shkurret.Dëgjova të mërmëriste nën zë se kjo ditë e bukur nuk i kishte sjellë fat e të tjera dërdëllitje si këto.

-U lodha, ulemi këtu?

çuditshme.Zogjtë cicëronin me rradhë,sikur i përgjigjeshin nga larg e lart njeri tjetrit me gjuhën e tyre.

Mahniteshe kur dëgjoje gurgullimën e ujit,si një ujvarë e vogël në hyrjet e urës,që formohej nga një digë e pjerrët.Stërkalat nga uji i shkumbëzuar mbas rrëmbesës përfundonin ne rrathë flluskash që plluskonin e shuheshin gjatë grykës e gjer në një rrjedhje të qetë. Klea ngriti pak kapelën e po mbante kasketën e saj në njërin cep.Ndërsa ajo kërkonte në hapsirë ndonje grup shokësh e shoqesh,unë vështroja flokët e saj te dallgëzuara ngjyrë gështenje,që e binin mbi supat e rrumb-ullakosura.Një kaçurrel i përdredhur i binte mbi ballin e bukur e nga bardhësia e lëkurës së lëmuar,ai merrte nuancën gështenjë të errët e sikur lodronte kur ajo kthente kokën sa andej këtej.Bukuria e saj në këtë qytet nordik po binte në sy.Kur ajo kalonte me atë të ecurëën e saj elegante e të veçantë, kalimtarët kthenin kokën e i buzëqeshnin.

Sa po gjente një shteg të hapur pak, ajo ecte duke larguar me dorë shkurret.Dëgjova të mërmëriste nën zë se kjo ditë e bukur nuk i kishte sjellë fat e të tjera dërdëllitje si këto.

-U lodha, ulemi këtu?

-Po nënë u hodh Mirko me këto degët e thata mund të ndërtojmë shtëpinë tonë e me shkathtësinë e tij filloi punën

-Klea që po i humbiste shpresat,u kthye rrëmbimthi nga ai.

- Dukesh që ke mendje kalamani. Shtëpinë e kemi ndërtuar në parqe të tjera, vetëm kur na zinte shiu të mos lageshim. Ha..ha... tani këto rrezet po të lagin?

Mirë që s'kisha nxjerrë akoma ujin,se mund të fillonim lojën me ujë për të lagur njëri tjetrin. Mirko i zënë ngushtë i tha:

-Unë po e ndërtoj për nënën,pasi ne mund të luajmë te këndi i lodrave përballë.Sa po shtrova shtrojën dhe një pecetë mbi të,vendosa ushqimet që mund të hanim në atë çast.Lëngun e frutave e kartpecetat i lashë anash.Gjysmë e shtrirë vura kufjet në vesh për t'u treguar indiferente,në mënyrë që ta zgjdhnin vetë lojën e tyre me njëri tjetrin.

-Nënë,ti i merr vendimet pa më pyetur mua? E kupton si ndjehem?

-Të lutem Klea luani të dy.

-Jo dua të iki që këtej,tani.

-Jo, do të rrimë.

-Po nënë u hodh Mirko me këto degët e thata mund të ndërtojmë shtëpinë tonë e me shkathtësinë e tij filloi punën

-Klea që po i humbiste shpresat,u kthye rrëmbimthi nga ai.

- Dukesh që ke mendje kalamani. Shtëpinë e kemi ndërtuar në parqe të tjera, vetëm kur na zinte shiu të mos lageshim. Ha..ha... tani këto rrezet po të lagin?

Mirë që s'kisha nxjerrë akoma ujin,se mund të fillonim lojën me ujë për të lagur njëri tjetrin. Mirko i zënë ngushtë i tha:

-Unë po e ndërtoj për nënën,pasi ne mund të luajmë te këndi i lodrave përballë.Sa po shtrova shtrojën dhe një pecetë mbi të,vendosa ushqimet që mund të hanim në atë çast.Lëngun e frutave e kartpecetat i lashë anash.Gjysmë e shtrirë vura kufjet në vesh për t'u treguar indiferente,në mënyrë që ta zgjdhnin vetë lojën e tyre me njëri tjetrin.

-Nënë,ti i merr vendimet pa më pyetur mua? E kupton si ndjehem?

-Të lutem Klea luani të dy.

-Jo dua të iki që këtej,tani.

-Jo, do të rrimë.

U pamë ngultasi në sy.Kundërshtimi i saj ishte i vendosur, por une duhet ta thyeja. Fjalët nuk hynin më në punë.Papritur ajo mori rrugën duke shpejtuar hapat.Nuk më la kohë as të mblidhja gjërat.Mirko kish gjuajtur topin larg e vraponte nga ana tjetër.Klea pa kthyer kokën vazhdonte të ecte.

- Klea... Klea... kthehu. Nuk mund të largohesh vetëm. Të lutem Klea... Klea.. Duke bërtitur fort, zëri po më ngjirej.Ndjeva lëmshin të më mblidhej në fyt.Lotët filluan të më rridhnin qysh në përcjelljen e parë.Po dridhesha që po më humbiste nga sytë.Mirko me topin në dorë u afrua me vrap.Ishim shumë të lidhura të dyja.Ajo e dinte që unë në atë moment vuaja duke ndjerë dhimbje përzier me fyerje.Mbulova fytyrën me duar për t'i fshehur lotët nga djali,por dënesën nuk po e ndalja dot.Ngashërimet tashmë kishin shpërthyer. Mirko me sytë e zmadhuar më vështronte me një dhimbje të tejskajshme. Më përqafoi duke m'i fshirë lotët.

- Nëna ime e mirë...mos qaj....mos qaj se do sëmuresh.

Ç'bëra? Si nuk vrapova pas saj? U mpiva e tëra.Parandjenjat po me shtynin në imagjinata të errëta.Ç'drejtim kishte marrë?Po sikur një makinë të frenonte pranë saj? Po sikur ajo derë

U pamë ngultasi në sy.Kundërshtimi i saj ishte i vendosur, por une duhet ta thyeja. Fjalët nuk hynin më në punë.Papritur ajo mori rrugën duke shpejtuar hapat.Nuk më la kohë as të mblidhja gjërat.Mirko kish gjuajtur topin larg e vraponte nga ana tjetër.Klea pa kthyer kokën vazhdonte të ecte.

- Klea... Klea... kthehu. Nuk mund të largohesh vetëm. Të lutem Klea... Klea.. Duke bërtitur fort, zëri po më ngjirej.Ndjeva lëmshin të më mblidhej në fyt.Lotët filluan të më rridhnin qysh në përcjelljen e parë.Po dridhesha që po më humbiste nga sytë.Mirko me topin në dorë u afrua me vrap.Ishim shumë të lidhura të dyja.Ajo e dinte që unë në atë moment vuaja duke ndjerë dhimbje përzier me fyerje.Mbulova fytyrën me duar për t'i fshehur lotët nga djali,por dënesën nuk po e ndalja dot.Ngashërimet tashmë kishin shpërthyer. Mirko me sytë e zmadhuar më vështronte me një dhimbje të tejskajshme. Më përqafoi duke m'i fshirë lotët.

- Nëna ime e mirë...mos qaj....mos qaj se do sëmuresh.

Ç'bëra? Si nuk vrapova pas saj? U mpiva e tëra.Parandjenjat po me shtynin në imagjinata të errëta.Ç'drejtim kishte marrë?Po sikur një makinë të frenonte pranë saj? Po sikur ajo derë

të hapej e vajza të frikësohej? O Zot ruaje Klean time,shpirtin e shpirtit tim.T'i telefonoj djalit.E shkreta unë,por çfare t'i them? M'i kishin besuar mua fëmijët.

Duart më ishin ngjitur në faqet e skuqura nga një avull i brendshëm e ndjeva që po me digjnin.

- Nënë...nënë u kthye Klea.Ja shiko atje tej...- dëgjoja Mirkon që më fliste me zë të lartë e duke tretur vështrimin në atë pikë që më orientonte ai,sikur po me shkundtte nga ajo kllapi e marrë.

Pashe siluetën e saj te shndriste nga rrezet e diellit.Kapelja qe dizenjuar me ngjyra të bukura në nuancat e ylberit e më ndihmonte të sigurohesha që po afrohej Klea ime.

- Nënë, është e mësuar keq. Sillet me ty si do ajo.- Mirko i vogël po gjykonte si ndonjë i madh.

Mos padashur kisha bërë diferencim mes tyre? Mos ajo përfitonte nga dobësia ime se e kisha mbesë të vetme?

- Po nëna e ty t'i plotëson dëshirat e mira. - Mos thuaj që na do njësoj,se njerëzit s'janë njësoj e dashuritë janë të ndryshme - e imitoi aq bukur Klean sa më bëri për të qeshur.

- Nënë ,Klea hyri në këndin e lodrave.

të hapej e vajza të frikësohej? O Zot ruaje Klean time,shpirtin e shpirtit tim.T'i telefonoj djalit.E shkreta unë,por çfare t'i them? M'i kishin besuar mua fëmijët.

Duart më ishin ngjitur në faqet e skuqura nga një avull i brendshëm e ndjeva që po me digjnin.

- Nënë...nënë u kthye Klea.Ja shiko atje tej...- dëgjoja Mirkon që më fliste me zë të lartë e duke tretur vështrimin në atë pikë që më orientonte ai,sikur po me shkundtte nga ajo kllapi e marrë.

Pashe siluetën e saj te shndriste nga rrezet e diellit.Kapelja qe dizenjuar me ngjyra të bukura në nuancat e ylberit e më ndihmonte të sigurohesha që po afrohej Klea ime.

- Nënë, është e mësuar keq. Sillet me ty si do ajo.- Mirko i vogël po gjykonte si ndonjë i madh.

Mos padashur kisha bërë diferencim mes tyre? Mos ajo përfitonte nga dobësia ime se e kisha mbesë të vetme?

- Po nëna e ty t'i plotëson dëshirat e mira. - Mos thuaj që na do njësoj,se njerëzit s'janë njësoj e dashuritë janë të ndryshme - e imitoi aq bukur Klean sa më bëri për të qeshur.

- Nënë ,Klea hyri në këndin e lodrave.

- Shko e ti loz me të!

- Jo pa të kërkuar falje ty!

- Me zemër ajo më ka kërkuar falje - i thashë me zë lutës.

U afrova pranë rrethinës e u ula në bar. S'kisha parë blirë erëmire aq të lartësuar.Aroma e tyre kundërmonte e ndjeva flladin e lehtë të më përkëdhelte.

Doja të rrija vetëm në qetësi të plotë. Të rradhisja me arsye ku kisha gabuar në lidhjen me Klean. Mos kisha ngatërruar pozicionin e gjyshes me nënën e saj?Mos isha bërë më shumë shoqe se gjyshe duke zbehur nuancat e autoritetit të duhur?Duhej marre nje vendim.Ta diskutoja ngjarjen me prindët e saj.Jo vetem që e ndjeva veten të pafuqishme, por të ndikonim për më të mirën e karakterit të saj.

Po sikur djalit t'i vinte keq për mua e ta gjykonte të bijën më shumë se duhej? Po të humbisja besimin e Kleas që më tregonte sekretet e moshës së saj, sikur fliste me vehten?

Kishim dy orë që s'komunikonim të dyja. Ishin bashkuar me moshatare të tyre duke lozur hareshëm. Herë pas herë Klea me hidhte ndonjë vështrim të merakosur fshehurazi.Mendonte që

- Shko e ti loz me të!

- Jo pa të kërkuar falje ty!

- Me zemër ajo më ka kërkuar falje - i thashë me zë lutës.

U afrova pranë rrethinës e u ula në bar. S'kisha parë blirë erëmire aq të lartësuar.Aroma e tyre kundërmonte e ndjeva flladin e lehtë të më përkëdhelte.

Doja të rrija vetëm në qetësi të plotë. Të rradhisja me arsye ku kisha gabuar në lidhjen me Klean. Mos kisha ngatërruar pozicionin e gjyshes me nënën e saj?Mos isha bërë më shumë shoqe se gjyshe duke zbehur nuancat e autoritetit të duhur?Duhej marre nje vendim.Ta diskutoja ngjarjen me prindët e saj.Jo vetem që e ndjeva veten të pafuqishme, por të ndikonim për më të mirën e karakterit të saj.

Po sikur djalit t'i vinte keq për mua e ta gjykonte të bijën më shumë se duhej? Po të humbisja besimin e Kleas që më tregonte sekretet e moshës së saj, sikur fliste me vehten?

Kishim dy orë që s'komunikonim të dyja. Ishin bashkuar me moshatare të tyre duke lozur hareshëm. Herë pas herë Klea me hidhte ndonjë vështrim të merakosur fshehurazi.Mendonte që

kisha marrë një vendim pasi isha lënduar shumë.

U shkëput e para nga loja. U afrua ngadalë e filloi të fërkonte duart e emocionuar.Bëja sikur isha e përqëndruar në leximin e një fjalori xhepi që e mbaja gjithmonë me vehte.

- Nënë i thashë atij çiftit të kishin kujdes me qenin mos të afrohej tek ty se mos trembeshe.

- Kam ndryshuar. Jam bërë më trime.

- Nënë të lutem më dëgjo.

- Për çfare?

M'u duk se po shtërngoja nofullat nga një inat që nuk ishte shfryrë gjer në fund. Ajo uli sytë përdhe me qerpikët e saponjomur nga lotët që shkëlqenin si rubin rreth tyre.

- Nënë më fal...nuk e përsëris më kurrë kurrë...gabova rëndë me ty që je personi më i dashur e më i rëndësishëm i jetës time. E di sa je lënduar e kam frikë mos të shtërngon zemra. Ti e di që unë s'e kuptoj dot jetën pa ty. Në fund të fundit do t'i them doktorit që jam gati ta jap zemrën ty po të duhet.

Fliste duke vazhduar t'i fërkonte duart me njëra tjetrën,me zërin që i dridhej bashkë me lëvizjet e tendosura të trupit të saj të bukur.U ngrita befas në këmbë, e e shtërngova fort në

kisha marrë një vendim pasi isha lënduar shumë.

U shkëput e para nga loja. U afrua ngadalë e filloi të fërkonte duart e emocionuar.Bëja sikur isha e përqëndruar në leximin e një fjalori xhepi që e mbaja gjithmonë me vehte.

- Nënë i thashë atij çiftit të kishin kujdes me qenin mos të afrohej tek ty se mos trembeshe.

- Kam ndryshuar. Jam bërë më trime.

- Nënë të lutem më dëgjo.

- Për çfare?

M'u duk se po shtërngoja nofullat nga një inat që nuk ishte shfryrë gjer në fund. Ajo uli sytë përdhe me qerpikët e saponjomur nga lotët që shkëlqenin si rubin rreth tyre.

- Nënë më fal...nuk e përsëris më kurrë kurrë...gabova rëndë me ty që je personi më i dashur e më i rëndësishëm i jetës time. E di sa je lënduar e kam frikë mos të shtërngon zemra. Ti e di që unë s'e kuptoj dot jetën pa ty. Në fund të fundit do t'i them doktorit që jam gati ta jap zemrën ty po të duhet.

Fliste duke vazhduar t'i fërkonte duart me njëra tjetrën,me zërin që i dridhej bashkë me lëvizjet e tendosura të trupit të saj të bukur.U ngrita befas në këmbë, e e shtërngova fort në

gjoksin tim duke e përkëdhelur e prekur nga çiltërsia e zërit që vinte nga thellësia e një shpirti akoma fëmijëror.

- Dritë e nënës....dielli im të kam falur. Të dua më shumë se jetën time.

- Unë më fort...unë më fort e duke e shtërnguar m'u duk sikur merrnim frymë njëkohësisht.

- Nënë jam e unë këtu që të dua fort - foli Mirko me atë zërin e tij të ëmbël e na vështronte me sytë e tij të shkruar që anonin më shumë në të gjelbër, në një qeshje në rrëshqitje.

- Po ty të ka nëna shpirt njeriu o njeri ! U përpoqa me dy duar, me sa fuqi që kisha ta ngrija sa më lart.

-Nënë, a na e plotëson një dëshirë? Është herët për t'u kthyer në shtëpi.Ushqime kemi akoma.Kalojmë nga ura për të shëtitur në anën tjetër të lumit? Duket më bukur e rruga është buzë lumit.

- Si thua Klea, shkojmë?- e pyeta me zë të ëmbël.

- Po të mundesh ti nënë, do të më pëlqente e mua.

- Shkojmë fëmijë drejt rrjedhjes së lumit!

gjoksin tim duke e përkëdhelur e prekur nga çiltërsia e zërit që vinte nga thellësia e një shpirti akoma fëmijëror.

- Dritë e nënës....dielli im të kam falur. Të dua më shumë se jetën time.

- Unë më fort...unë më fort e duke e shtërnguar m'u duk sikur merrnim frymë njëkohësisht.

- Nënë jam e unë këtu që të dua fort - foli Mirko me atë zërin e tij të ëmbël e na vështronte me sytë e tij të shkruar që anonin më shumë në të gjelbër, në një qeshje në rrëshqitje.

- Po ty të ka nëna shpirt njeriu o njeri ! U përpoqa me dy duar, me sa fuqi që kisha ta ngrija sa më lart.

-Nënë, a na e plotëson një dëshirë? Është herët për t'u kthyer në shtëpi.Ushqime kemi akoma.Kalojmë nga ura për të shëtitur në anën tjetër të lumit? Duket më bukur e rruga është buzë lumit.

- Si thua Klea, shkojmë?- e pyeta me zë të ëmbël.

- Po të mundesh ti nënë, do të më pëlqente e mua.

- Shkojmë fëmijë drejt rrjedhjes së lumit!

Dolëm në pjesën e sipërme të urës duke ecur mbështetur nëfasadat e saj. Makinat ecnin njëra pas tjetrës me shpejtësi marramendëse.Zbritëm rrëpirën duke u mbajtur për dore, derisa arritëm te shkallët me parmakë hekuri, të lyera me bojë vaji në ngjyrë jeshile të errët.Sakaq u gjendem në rrugën e ngushtë buzë lumit ,që gjarpëronte në drejtim të rrjedhës së tij.Dy mjelma të bardha të mëdha kishin dalë në breg,duke i lënë të vegjëlit e tyre të loznin së bashku në ujë, në kthinen e një oazi të qetë nga valët e lehta.

- Nënë, po vijnë të uritura drejt nesh - dëgjova zërin e trembur të Mirkos.

Ato ecnin duke u tundur herë në njërën anë e herë në tjetrën e me qafën të mbledhur me shikim të qetë e triumfues.

- Sa frikacak që je! Nuk të hanë!

- Afrohu pranë tyre Klea,si trime që je!

- E pranoj që frikë kam vetëm qentë të rracës Big Bull,ata të mëdhenjtë që i janë larguar të zotit, pa mbrojtëse në gojë.

- Ha ...ha unë të kam pare që ti ke frikë e nga qentë e vegjël.

- Nga e di ti? Une nuk e shfaq, e mbaj nga brenda.Pastaj ku i njoh? Vallë, më njohin?

Dolëm në pjesën e sipërme të urës duke ecur mbështetur nëfasadat e saj. Makinat ecnin njëra pas tjetrës me shpejtësi marramendëse.Zbritëm rrëpirën duke u mbajtur për dore, derisa arritëm te shkallët me parmakë hekuri, të lyera me bojë vaji në ngjyrë jeshile të errët.Sakaq u gjendem në rrugën e ngushtë buzë lumit ,që gjarpëronte në drejtim të rrjedhës së tij.Dy mjelma të bardha të mëdha kishin dalë në breg,duke i lënë të vegjëlit e tyre të loznin së bashku në ujë, në kthinen e një oazi të qetë nga valët e lehta.

- Nënë, po vijnë të uritura drejt nesh - dëgjova zërin e trembur të Mirkos.

Ato ecnin duke u tundur herë në njërën anë e herë në tjetrën e me qafën të mbledhur me shikim të qetë e triumfues.

- Sa frikacak që je! Nuk të hanë!

- Afrohu pranë tyre Klea,si trime që je!

- E pranoj që frikë kam vetëm qentë të rracës Big Bull,ata të mëdhenjtë që i janë larguar të zotit, pa mbrojtëse në gojë.

- Ha ...ha unë të kam pare që ti ke frikë e nga qentë e vegjël.

- Nga e di ti? Une nuk e shfaq, e mbaj nga brenda.Pastaj ku i njoh? Vallë, më njohin?

Mirko nxorri nga çanta bukën e po ua hidhte mjelmave.

Klea po ushqente të vegjëlit,që nga gëzimi po bënin një spektakël fantastik. Ata herë zhyteshin në uje e herë nxirrnin kokën nga uji. Disa me puplat e sapodala në ngjyrë zhuzhi e të tjera në kafe të kadifenjtë, shkundeshin hareshëm të përkëdhelura nga freskia.Turreshin me pasthirrma të gagave të tyre, për të kapur copat e bukës,që qëndronin si petashuqe të fryra mbi ujë.Kur pamë Mirkon që ushqente mjelmat duke bërë hapa prapa, me sytë e zmadhuar nga frika, kur ato zgjasnin qafen tejet të gjatë, me sqepin e madh të hapur,ne te dyja me Klean, shkriheshim së qeshuri.Mjelmat me të vegjëlit po hynin në rrjedhën e ujit e ne dëgjonim nga prapa rrahjen e krahëve të tyre në ujë.

Nga ana tjetër e rrugës, pemët sa vinin, ishin më të larta, e bëheshin më të dendura.Akaciet të përdredhura rreth pemës gjer lart në majë, të krijonin përshtypjen se ishte e pamundur të hyje në këtë dendësi,me nuanca të blerta, nga më e errëta, deri në më të ëmblën e saj.

- Nënë, janë disa shkallë në ngjitje, në drejtim të pyllit.Si thua, mund të futemi në pyll?

Tabela e shkruar bukur" Welcome" të ndillte të mos u mendoheshe shumë. Pas saj në një

Mirko nxorri nga çanta bukën e po ua hidhte mjelmave.

Klea po ushqente të vegjëlit,që nga gëzimi po bënin një spektakël fantastik. Ata herë zhyteshin në uje e herë nxirrnin kokën nga uji. Disa me puplat e sapodala në ngjyrë zhuzhi e të tjera në kafe të kadifenjtë, shkundeshin hareshëm të përkëdhelura nga freskia.Turreshin me pasthirrma të gagave të tyre, për të kapur copat e bukës,që qëndronin si petashuqe të fryra mbi ujë.Kur pamë Mirkon që ushqente mjelmat duke bërë hapa prapa, me sytë e zmadhuar nga frika, kur ato zgjasnin qafen tejet të gjatë, me sqepin e madh të hapur,ne te dyja me Klean, shkriheshim së qeshuri.Mjelmat me të vegjëlit po hynin në rrjedhën e ujit e ne dëgjonim nga prapa rrahjen e krahëve të tyre në ujë.

Nga ana tjetër e rrugës, pemët sa vinin, ishin më të larta, e bëheshin më të dendura.Akaciet të përdredhura rreth pemës gjer lart në majë, të krijonin përshtypjen se ishte e pamundur të hyje në këtë dendësi,me nuanca të blerta, nga më e errëta, deri në më të ëmblën e saj.

- Nënë, janë disa shkallë në ngjitje, në drejtim të pyllit.Si thua, mund të futemi në pyll?

Tabela e shkruar bukur" Welcome" të ndillte të mos u mendoheshe shumë. Pas saj në një

dizenjo të bukur ishte pikturuar harta e pyllit. Ishin shënuar kafshët e buta e tëegra, shpezëtt e ndryshme e zvarranike, insekte, nga të cilat duhej të kishe kujdes. Në thellësi të pyllit ravijëzohesh në hartë një rezervuar me ngjyrë të kaltër, ku shënoheshin llojet e peshqve e lejohej peshkimi i tyre.

Pran nesh kaloi një çift me një fëmijë të vogël faqekuq që na buzëqeshte. Burri e mbajti djalin për dore e na tregoi drejtimin e rrugës, që duhej ta ndiqnim.

Më tej na u shfaq një lëndinë pak e ngritur, në formën e një kodrine të vogël. Aroma e luleve të para, të porsaçelura, shpërndahej me flladin e lehtë.

Lulet e borës zbardhnin mes lule delesh, e mua m'u kujtua fëmijëria ime me ato bredhjet e hareshme ,duke mbledhur lule e i thurnim kurorë. Manushaqet kishin çelur të parat, pasi petalet e tyre në ngjyrëvishnje të theksuar në lejla, ishin të hapura plotësisht deri në gonxhet e fundit! Disa zymbyla vareshin si këmbore ,duke shpërndarë aromën e tyre dehëse.Mahnitëse! Gjithçka brenda virgjërisë pyjore pa fund!

Mirko me jakën e këmishës të zbërthyer gjer në gjoks, mblidhte degë të thata pemësh e i

dizenjo të bukur ishte pikturuar harta e pyllit. Ishin shënuar kafshët e buta e tëegra, shpezëtt e ndryshme e zvarranike, insekte, nga të cilat duhej të kishe kujdes. Në thellësi të pyllit ravijëzohesh në hartë një rezervuar me ngjyrë të kaltër, ku shënoheshin llojet e peshqve e lejohej peshkimi i tyre.

Pran nesh kaloi një çift me një fëmijë të vogël faqekuq që na buzëqeshte. Burri e mbajti djalin për dore e na tregoi drejtimin e rrugës, që duhej ta ndiqnim.

Më tej na u shfaq një lëndinë pak e ngritur, në formën e një kodrine të vogël. Aroma e luleve të para, të porsaçelura, shpërndahej me flladin e lehtë.

Lulet e borës zbardhnin mes lule delesh, e mua m'u kujtua fëmijëria ime me ato bredhjet e hareshme ,duke mbledhur lule e i thurnim kurorë. Manushaqet kishin çelur të parat, pasi petalet e tyre në ngjyrëvishnje të theksuar në lejla, ishin të hapura plotësisht deri në gonxhet e fundit! Disa zymbyla vareshin si këmbore ,duke shpërndarë aromën e tyre dehëse.Mahnitëse! Gjithçka brenda virgjërisë pyjore pa fund!

Mirko me jakën e këmishës të zbërthyer gjer në gjoks, mblidhte degë të thata pemësh e i

hidhte rrugës, për të qenë i sigurtë kur të ktheheshim.

- Frika t’i ka mësuar të gjitha këto imagjinata! - i tha Klea duke qeshur.

- Mirë e ke ti,por kur të mbeteni të hutuara ju të dyja, mos gjeni shtegun e duhur, si t'ia bëj unë? Apo s'qani shpejt ju vajzat kur humbni rrugën.

- Edhe ti ke qarë - i tha Klea me një zë që s' mund ta kundërshtoje.

- E vërtetë, kam qarë, por ne djemtë e rritur qajmë për gjëra shumë të rëndësishme. Ndërkohë më mori djali në telefon e dëgjova zërin e merakosur të tij:

- Mirë jeni? U vonuat shumë. Ku ndodheni të vijmë t'ju marrim?

U ndjeva e zënë ngusht.

- Mos u nisni ! Këtej nuk ka rrugë makinash .

- Kthehuni,se po ndoqët pyllin do të dilni jashte qytetit!

- Më duket se e dëgjoj rrjedhën e lumit.

- Ndiqe anën e kundërt të rrymës e po ishit të lodhur, njofto të presim te ura! Mirko po lozte me topin me dy të rinj, që dolën nga një shteg aty pranë. Vajza që ishte me ta, po bisedonte me Klean.

hidhte rrugës, për të qenë i sigurtë kur të ktheheshim.

- Frika t'i ka mësuar të gjitha këto imagjinata! - i tha Klea duke qeshur.

- Mirë e ke ti,por kur të mbeteni të hutuara ju të dyja, mos gjeni shtegun e duhur, si t'ia bëj unë? Apo s'qani shpejt ju vajzat kur humbni rrugën.

- Edhe ti ke qarë - i tha Klea me një zë që s' mund ta kundërshtoje.

- E vërtetë, kam qarë, por ne djemtë e rritur qajmë për gjëra shumë të rëndësishme. Ndërkohë më mori djali në telefon e dëgjova zërin e merakosur të tij:

- Mirë jeni? U vonuat shumë. Ku ndodheni të vijmë t'ju marrim?

U ndjeva e zënë ngusht.

- Mos u nisni ! Këtej nuk ka rrugë makinash .

- Kthehuni,se po ndoqët pyllin do të dilni jashte qytetit!

- Më duket se e dëgjoj rrjedhën e lumit.

- Ndiqe anën e kundërt të rrymës e po ishit të lodhur, njofto të presim te ura! Mirko po lozte me topin me dy të rinj, që dolën nga një shteg aty pranë. Vajza që ishte me ta, po bisedonte me Klean.

Mbushën duart me lule e m'i sollën si dhuratë.Flokët kaçurela në ngjyrën bronxi në të kuqe, i jepnin syve në ngjyrën blu nuanca të ndryshme. Me atë rrezatim shend e verë, me trupin e hollë e të hajthshëm, ajo hidhte shikimin te shokët. Ata loznin me Mirkon, e herë pas here kthenin kanaçen e pepsit nga etja. Mirko shpesh më humbiste nga sytë,pasi largohej nëpër gëmusha për ta kapur topin, si më i vogel që ishte.Një moment dëgjoj fishkëllimën e një lokomotive treni me vagonë të vegjël, por i gjatë.

U ngrita menjëherë e thirra e tmerruar :

- Mirko....Mirko....e vështroja e hutuar, duke u afruar pranë trenit, që me dukej sikur s'kish mbarim!

- Nënë, mos u tremb,thirri Klea, që s'dukej e qetë.

- E shkreta unë djali!

Kejti,siç e quanin vajzën, i pa shokët me vërejtje. Ata ulën sytë sikur po mbanin një faj të rëndë.

- Mos u shqetëso ,se Mirko ishte në anën tjetër larg shinave, për ta kaluar topin.

Vura duart në kokë e thërrisja me sa fuqi që kisha:

Mbushën duart me lule e m’i sollën si dhuratë.Flokët kaçurela në ngjyrën bronxi në të kuqe, i jepnin syve në ngjyrën blu nuanca të ndryshme. Me atë rrezatim shend e verë, me trupin e hollë e të hajthshëm, ajo hidhte shikimin te shokët. Ata loznin me Mirkon, e herë pas here kthenin kanaçen e pepsit nga etja. Mirko shpesh më humbiste nga sytë,pasi largohej nëpër gëmusha për ta kapur topin, si më i vogel që ishte.Një moment dëgjoj fishkëllimën e një lokomotive treni me vagonë të vegjël, por i gjatë.

U ngrita menjëherë e thirra e tmerruar :

- Mirko....Mirko....e vështroja e hutuar, duke u afruar pranë trenit, që me dukej sikur s'kish mbarim!

- Nënë, mos u tremb,thirri Klea, që s'dukej e qetë.

- E shkreta unë djali!

Kejti,siç e quanin vajzën, i pa shokët me vërejtje. Ata ulën sytë sikur po mbanin një faj të rëndë.

- Mos u shqetëso ,se Mirko ishte në anën tjetër larg shinave, për ta kaluar topin.

Vura duart në kokë e thërrisja me sa fuqi që kisha:

- Mirko....Mirko mos lëviz, rri i qetë deri sa të largohet treni.

-Nënë!Klea... jam mirë... mos u shqetësoni...thërriste Mirko i trembur.

M’u shkri gjaku kur e pashë tek shtërngonte fort topin e tij të dashur e buzëqeshte mes frikës së tij e tonës.

Të dy djemtë e shtërguan me dashuri, e bënë atë shenjën e preferuar, duke rrahur duart me njëri tjetrin shumë në modë për djemtë e rinj anglezë, HI-FI me Mirkon e u larguan të tre në drejtim të rezervoarit në mes të pyllit.Kejti kthente kokën herë pas here e na përshëndeste me dorë deri sa u zhduk.

- Nënë, më erdhi zor që u alarmove aq shume në syte e tyre. Unë jam i madh e ai tren ishte i gjatë, por ishte si tren xhuxhash - Sikur ta dija, që në atë tunel pemësh kalonte treni, s'do të isha tmerruar as vetë, as ju e as ata që ishin aq të mirë.
Por pyjet angleze qenkan të çuditshme. Unë nuk e fiksova këtë detaj të rëndësishëm në hartë.

- Më fal nënë,më takonte mua ta studioja mirë - tha Klea.

Rruga në kthim ishte e lehtë nga shenjat që kish lënë Mirko, që po hiqej si komandant i

- Mirko....Mirko mos lëviz, rri i qetë deri sa të largohet treni.

-Nënë!Klea... jam mirë... mos u shqetësoni...thërriste Mirko i trembur.

M'u shkri gjaku kur e pashë tek shtërngonte fort topin e tij të dashur e buzëqeshte mes frikës së tij e tonës.

Të dy djemtë e shtërguan me dashuri, e bënë atë shenjën e preferuar, duke rrahur duart me njëri tjetrin shumë në modë për djemtë e rinj anglezë, HI-FI me Mirkon e u larguan të tre në drejtim të rezervoarit në mes të pyllit.Kejti kthente kokën herë pas here e na përshëndeste me dorë deri sa u zhduk.

- Nënë, më erdhi zor që u alarmove aq shume në syte e tyre. Unë jam i madh e ai tren ishte i gjatë, por ishte si tren xhuxhash - Sikur ta dija, që në atë tunel pemësh kalonte treni, s'do të isha tmerruar as vetë, as ju e as ata që ishin aq të mirë.
Por pyjet angleze qenkan të çuditshme. Unë nuk e fiksova këtë detaj të rëndësishëm në hartë.

- Më fal nënë,më takonte mua ta studioja mirë - tha Klea.

Rruga në kthim ishte e lehtë nga shenjat që kish lënë Mirko, që po hiqej si komandant i

grupit.Duke pirë lëngjet e fundit ,gjetëm anën e zbritjes së shkallëve buzë lumit.

Mirko, që nuk ndjente lodhje,filloi ta puthte topin në rrugën e ngushtë.

- Mirko, mos se do te bjeri topi ne lume!

- e porosita dy tri here.

- Po s'e mbajte dot ti, ta mban motra! Hapat i hidhnim ngadalë nga lodhja.

Mirko përsëri e gjuajti topin e kur shkoi me shpejtësi ta kapte, topi u rrokullis drejt e në lumë.

- Nënë....nënë...Nënë....nënë.... - u kthye nga unë i mërzitur.

Sytë në ngjyrën jeshile i ishin zmadhuar nga habia,e vështrimi i tij kish marrë papritur mënyrën pyetëse akoma të pashprehur.I shkela syrin Kleas,që ishte gati ta fajësonte.

Rrjedha që ishte bërë më e rrëmbyer,po e merrte topin me shpejtësi përpara.Njëra nga valët e shtyu në anën tjetër të bregut,ku shkëlqenin myshqe të ngjitura pas faqes së gërryer. Rosat që po notonin të rreshtuar një nga një, devijuan për t'u shmangur nga topi që tashmë nën reflektimin e rrezeve të diellit në perëndim, po thyente nuancat e tij.

grupit.Duke pirë lëngjet e fundit ,gjetëm anën e zbritjes së shkallëve buzë lumit.

Mirko, që nuk ndjente lodhje,filloi ta puthte topin në rrugën e ngushtë.

- Mirko, mos se do te bjeri topi ne lume!

- e porosita dy tri here.

- Po s'e mbajte dot ti, ta mban motra! Hapat i hidhnim ngadalë nga lodhja.

Mirko përsëri e gjuajti topin e kur shkoi me shpejtësi ta kapte, topi u rrokullis drejt e në lumë.

- Nënë....nënë...Nënë....nënë.... - u kthye nga unë i mërzitur.

Sytë në ngjyrën jeshile i ishin zmadhuar nga habia,e vështrimi i tij kish marrë papritur mënyrën pyetëse akoma të pashprehur.I shkela syrin Kleas,që ishte gati ta fajësonte.

Rrjedha që ishte bërë më e rrëmbyer,po e merrte topin me shpejtësi përpara.Njëra nga valët e shtyu në anën tjetër të bregut,ku shkëlqenin myshqe të ngjitura pas faqes së gërryer. Rosat që po notonin të rreshtuar një nga një, devijuan për t'u shmangur nga topi që tashmë nën reflektimin e rrezeve të diellit në perëndim, po thyente nuancat e tij.

- Nënë,dua topin tim! Të tre dimë not. Eja ta kapim!

- Shpirti i nënës! Të tre kemi notuar në det. Lumenjtë janë më të rrezikshëm e për notarët e mirë.

- Mirko është e pamundur, dhe pikë! Le te lozin rosat e mjelmat! Është surprizë e bukur për to - i mbushte mendjen Klea,duke i hedhur dorën në qafë.

Mirko mblodhi buzët! Tiparet e tkurrura me vështrimin te topi,të jepnin përshtypjen sikur po humbiste gjysmën e botës së tij fëmijërore.

- Eja zemër,mos e kthe kokën prapa! Ai nuk do mbytet,por do qëndrojë përherë përmbi ujë.

- Jo nënë,të paktën më lërë deri sa tëzhduket.
Sa më shumë rrjedha e merrte përpara,topi zvogëlohej në përmasat e tij, aq me shumë dhimbje kishte përhumbja e shikimit të Mirkos!

- Të blen motra ty një tjetër top të ri! Kam shumë paund që mblodha për ditëlindje.
- Kushton më shumë,pasi kisha bërë shume gola e të gjithë më kanë quajtur nëpër ndeshje futbolli Mesi i ardhshëm.

- Nënë,dua topin tim! Të tre dimë not. Eja ta kapim!

- Shpirti i nënës! Të tre kemi notuar në det. Lumenjtë janë më të rrezikshëm e për notarët e mirë.

- Mirko është e pamundur, dhe pikë! Le te lozin rosat e mjelmat! Është surprizë e bukur për to - i mbushte mendjen Klea,duke i hedhur dorën në qafë.

Mirko mblodhi buzët! Tiparet e tkurrura me vështrimin te topi,të jepnin përshtypjen sikur po humbiste gjysmën e botës së tij fëmijërore.

- Eja zemër,mos e kthe kokën prapa! Ai nuk do mbytet,por do qëndrojë përherë përmbi ujë.

- Jo nënë,të paktën më lërë deri sa tëzhduket.
Sa më shumë rrjedha e merrte përpara,topi zvogëlohej në përmasat e tij, aq me shumë dhimbje kishte përhumbja e shikimit të Mirkos!

- Të blen motra ty një tjetër top të ri! Kam shumë paund që mblodha për ditëlindje.
- Kushton më shumë,pasi kisha bërë shume gola e të gjithë më kanë quajtur nëpër ndeshje futbolli Mesi i ardhshëm.

Klea ja dha të qeshurit e filloi ta guduliste. Në momentin që ajo priste të qeshuren e tij, Mirko filloi të qante me të madhe.

E përkëdhela në flokët e lëmuar me shumë dashuri e i dhashë ujë të pinte. Shpërthimi i tij sikur vinte valë valë në një dënesë të mbytur.

- Nuk qaj më për topin,por për diçka tjetër ,që nuk e them dot.

- Thuaja motrës,po s'deshe ta di nëna!

- Klea si do ja bëj une kur të vdesi nëna?
- Mos na dëgjojeë,ule zërin! Edhe une e mendoj kur sëmuret e qaj fshehurazi Mirko! Ja pse jemi motër e vëlla,se kemi të njëjtin shqetësim.

I dëgjoja duke më ardhur për të qeshur. Mirko akoma lotonte e po më dhimbsej.

- Nëna ime si do jetoj une kur të vdesësh ti?

- S'di të mbash njësekret - u hodh Klea duke psherëtirë ,sikur gjëma po ndodhte.

- Eja shpirt i nënës ,më trego sa shenja të vrarash ke tek kembet? Ai ngriti i bindur pantallonat gjer tek gjuri.Sa herë vritesh nuk i tregonte shenjat e nxira, as dhimbjet, as gjakosjet.

- Bobo, mor Mirko sa je vrarë nëpër gjithë trupin ndoshta i tha Klea që i zmadhonte më shumë gjërat.

Klea ja dha të qeshurit e filloi ta guduliste. Në momentin që ajo priste të qeshuren e tij, Mirko filloi të qante me të madhe.

E përkëdhela në flokët e lëmuar me shumë dashuri e i dhashë ujë të pinte. Shpërthimi i tij sikur vinte valë valë në një dënesë të mbytur.

- Nuk qaj më për topin,por për diçka tjetër ,që nuk e them dot.

- Thuaja motrës,po s'deshe ta di nëna!

- Klea si do ja bëj une kur të vdesi nëna?
- Mos na dëgjojeë,ule zërin! Edhe une e mendoj kur sëmuret e qaj fshehurazi Mirko! Ja pse jemi motër e vëlla,se kemi të njëjtin shqetësim.

I dëgjoja duke më ardhur për të qeshur. Mirko akoma lotonte e po më dhimbsej.

- Nëna ime si do jetoj une kur të vdesësh ti?

- S'di të mbash njësekret - u hodh Klea duke psherëtirë ,sikur gjëma po ndodhte.

- Eja shpirt i nënës ,më trego sa shenja të vrarash ke tek kembet? Ai ngriti i bindur pantallonat gjer tek gjuri.Sa herë vritesh nuk i tregonte shenjat e nxira, as dhimbjet, as gjakosjet.

- Bobo, mor Mirko sa je vrarë nëpër gjithë trupin ndoshta i tha Klea që i zmadhonte më shumë gjërat.

Kur Mirko kujtohej për topin me mendjen e tij ,përsëri i vinte vala e të qarit me vdekjen e nënës.

- Eja Mirko të tregojë nëna diçka. Një ditë mbase kjo do të jetë e larget , unë do të bëhem engjëlli mbrojtës i yti lart në qiell. Përsëri do të jete bukur, sepse sa herë të shikosh qiellin,ty do të kujtohet nëna jote me sy të kaltër. Do të ndodhin plot mrekullira, sepse ti je shpirt njeriu. Kur ti te rrëzohesh , nëna do të ngrejë me zërin e shpirtit pa rënë akoma në tokë. Ti nuk do të vritesh më. Zëri i shpirtit të nënës do jetë I ëmbël kur të të pyesi:

- Mirko ,çohu! U vrave bir? A të dhemb?- edhe pse nëna të ka ngritur para se të rrëzohesh.Mirkos po i shkëlqenin sytë nga një habi e mirënjohje e thellë.Mbështeti kokën në gjoksin tim e pastaj me zërin e tij tashmë të çliruar nga dënesat tha:

- Nënë, askush nuk m'i ka thënë mua më parë këto fjalë, që më ngrohin zemrën aq shumë.

- Po nëna, Mirko i dinë mirë disa sekrete , prandaj nuk dua të shoh të mërzitur e të qash.Nga prapa nesh u dëgjua motorri i një varke të madhe.Isha kurioze ta shikoja nga afër.

Kur Mirko kujtohej për topin me mendjen e tij ,përsëri i vinte vala e të qarit me vdekjen e nënës.

- Eja Mirko të tregojë nëna diçka. Një ditë mbase kjo do të jetë e larget , unë do të bëhem engjëlli mbrojtës i yti lart në qiell. Përsëri do të jete bukur, sepse sa herë të shikosh qiellin,ty do të kujtohet nëna jote me sy të kaltër. Do të ndodhin plot mrekullira, sepse ti je shpirt njeriu. Kur ti te rrëzohesh , nëna do të ngrejë me zërin e shpirtit pa rënë akoma në tokë. Ti nuk do të vritesh më. Zëri i shpirtit të nënës do jetë I ëmbël kur të të pyesi:

- Mirko ,çohu! U vrave bir? A të dhemb?- edhe pse nëna të ka ngritur para se të rrëzohesh.Mirkos po i shkëlqenin sytë nga një habi e mirënjohje e thellë.Mbështeti kokën në gjoksin tim e pastaj me zërin e tij tashmë të çliruar nga dënesat tha:

- Nënë, askush nuk m'i ka thënë mua më parë këto fjalë, që më ngrohin zemrën aq shumë.

- Po nëna, Mirko i dinë mirë disa sekrete , prandaj nuk dua të shoh të mërzitur e të qash.Nga prapa nesh u dëgjua motorri i një varke të madhe.Isha kurioze ta shikoja nga afër.

Kabina e saj në formën e stërgjatur kish disa ndarje. Dritaret e vogla të lyera reflektonin në ngjyrën e llakut me shkëlqim.Aty ku vareshin perde të bardha ,të punuara me grep, ishte pjesa e guzhinës. Pas koridorit vinin me rradhë dhomat e gjumit e të ndenijës.Nga bordi koridoret anësore ishin te ngushta.Në krye pranë motorrit qëndronte një grua rreth të pesëdhjetave. Era e lehtë ia tundte flokët ngjyrë bakri të gjata e të lëshuara. Pranë saj u afrua një burrë e diç po i tregonte asaj me shikimin nga ne. Ndjeva që u skuqa gjer te veshët. Mos vallë isha treguar më shumë kurioze se sa duhej ?Përsëri në anën tjetër të bordit më tërhoqi vëmendjen një çift simpatik, që ishin përkulur më shumë seç duhej. Në dorë mbanin një shkop të gjatë. Kujtova se po peshkonin.

- Mirko, topi yt....Ja atje tej.... - thërriste Klea duke kërcyer nga gëzimi. Mirko nuk po i besonte syve, kur pa topin të lëkundej sa andej këtej mbi valë. B

urri një trup muskuloz, me lëkurë të nxirë nga dielli ngadalësoi shpejtësinë e varkës. Një varkëpo aq e madhe , por me motorr më të fuqishëm po afrohej pranë tij.I kish parë që larg që diçka e papritur kish ndodhur.Burri me një bluzë të bardhë e kapelë me ngjyrat e flamurit anglez dukej serioz me sytë në formën e

Kabina e saj në formën e stërgjatur kish disa ndarje. Dritaret e vogla të lyera reflektonin në ngjyrën e llakut me shkëlqim.Aty ku vareshin perde të bardha ,të punuara me grep, ishte pjesa e guzhinës. Pas koridorit vinin me rradhë dhomat e gjumit e të ndenijës.Nga bordi koridoret anësore ishin te ngushta.Në krye pranë motorrit qëndronte një grua rreth të pesëdhjetave. Era e lehtë ia tundte flokët ngjyrë bakri të gjata e të lëshuara. Pranë saj u afrua një burrë e diç po i tregonte asaj me shikimin nga ne. Ndjeva që u skuqa gjer te veshët. Mos vallë isha treguar më shumë kurioze se sa duhej ?Përsëri në anën tjetër të bordit më tërhoqi vëmendjen një çift simpatik, që ishin përkulur më shumë seç duhej. Në dorë mbanin një shkop të gjatë. Kujtova se po peshkonin.

- Mirko, topi yt....Ja atje tej.... - thërriste Klea duke kërcyer nga gëzimi. Mirko nuk po i besonte syve, kur pa topin të lëkundej sa andej këtej mbi valë. B

urri një trup muskuloz, me lëkurë të nxirë nga dielli ngadalësoi shpejtësinë e varkës. Një varkëpo aq e madhe , por me motorr më të fuqishëm po afrohej pranë tij.I kish parë që larg që diçka e papritur kish ndodhur.Burri me një bluzë të bardhë e kapelë me ngjyrat e flamurit anglez dukej serioz me sytë në formën e

bajames, e priste me padurim t'i hapnin rrugën.Topi nganjehere nuk i bindej shtytjes se tyre. Diçka bisedonin për ta tërhequr topin pranë vetes. Vajza ,që kish -veshur pantallona të shkurtra,që ja tregonin këmbët e bukura e të drejta , me shkathtësinë e saj e kapi topin, e pa e përqendruar mirë ndër duar , e hodhi në drejtim të Mirkos.Për fat të keq topi nuk arriti pranë Mirkos , e ra prapë në ujë.

- Nënë, dua t'i falënderoj dhe të iki me vrap.I thamë Thank you e po i bindeshim Mirkos pa e kthyer kokën .Nuk po dëgjonim zhurmën e fuqishme tëmotorrit në nisje.Ktheva kokën e u çudita që ata merreshin akoma me topin. Merrte pjesë e varkëtari tjetër. E kish kthyer varkën në mënyrë paralele ,që topin mos ta merrte përpara rrjedha e shkumbëzuar. Ndaluam si të gozhduar në vend.

- Herë pas herë ashtu të munduar i buzëqeshnin Mirkos.Varkëtari i parë la të shoqen në vendin e tij e i tha djalit të hipte në bordurën e hollë.Djalit po i lëkundej trupi e dukej se po humbisteekuilibrin.Mirko mbuloi fytyrën me duar e me zë lutës tha:

- Nënë nuk e dua më topin.Të lutem Klea thuaji ti se më vjen zor.Po sikur ai djali të bie në lumë? Ah për fajin tim nënë....për fajin tim ai mund të mbytet në ujë. Kur varkëtari tjetër i

bajames, e priste me padurim t'i hapnin rrugën.Topi nganjehere nuk i bindej shtytjes se tyre. Diçka bisedonin për ta tërhequr topin pranë vetes. Vajza ,që kish -veshur pantallona të shkurtra,që ja tregonin këmbët e bukura e të drejta , me shkathtësinë e saj e kapi topin, e pa e përqendruar mirë ndër duar , e hodhi në drejtim të Mirkos.Për fat të keq topi nuk arriti pranë Mirkos , e ra prapë në ujë.

- Nënë, dua t'i falënderoj dhe të iki me vrap.I thamë Thank you e po i bindeshim Mirkos pa e kthyer kokën .Nuk po dëgjonim zhurmën e fuqishme tëmotorrit në nisje.Ktheva kokën e u çudita që ata merreshin akoma me topin. Merrte pjesë e varkëtari tjetër. E kish kthyer varkën në mënyrë paralele ,që topin mos ta merrte përpara rrjedha e shkumbëzuar. Ndaluam si të gozhduar në vend.

- Herë pas herë ashtu të munduar i buzëqeshnin Mirkos.Varkëtari i parë la të shoqen në vendin e tij e i tha djalit të hipte në bordurën e hollë.Djalit po i lëkundej trupi e dukej se po humbisteekuilibrin.Mirko mbuloi fytyrën me duar e me zë lutës tha:

- Nënë nuk e dua më topin.Të lutem Klea thuaji ti se më vjen zor.Po sikur ai djali të bie në lumë? Ah për fajin tim nënë....për fajin tim ai mund të mbytet në ujë. Kur varkëtari tjetër i

mëshoi shkopit ,që përfundonte në formën e një krrabe topi përfundoi pranë gruas që gjysmë e shtrirë arriti ta kapte.

- Afruan varkën afër bregut duke rakorduar veprimet me kujdes me varkëtarin tjetër që mos përplaseshin.Ajo ja hodhi topin Mirkos që bëri një pritje të bukur spektakolare për kënaqësinë e tyre.Ata qeshën me zë dhe ndezën motorrat duke ndjekur anën e kundërt të rrymës. Gjithmonë në ikje para nesh derisa u zhduken ,na e bënin herë pas herë me dorë! Fjala Thank you na kish mbetur në buzë në një kujtim të bukur që s'do ta harronim kurrë.Ndonjëherë më ishte krijuar përshtypja se anglezët ishin të ftohtë.Nga mënyra si komunikonin të jepnin të kuptoje se ishin moskokëçarës me gotat e birrës jo deri në masën e dehjes, që s' i ndanin nga duart.

Dielli po përshëndetej me gjysmë diskun e hënës së sapodalë,që nuk kish marrë atë ngjyrën e ndritur të së verdhës së ndezur. Tisi i muzgut akoma nuk kish rënë e nëpër pemë dëgjoheshin levizjet e shpejta te ketrave ,qe s'e kishin mbaruar akoma lojën mes tyre.Ishim afruar pranë urës nga ku gurgullima e ujit dëgjohej më e fortë drejt rrjedhës së lumit.

*Angli*
*28 - 4 - 2018*

mëshoi shkopit ,që përfundonte në formën e një krrabe topi përfundoi pranë gruas që gjysmë e shtrirë arriti ta kapte.

- Afruan varkën afër bregut duke rakorduar veprimet me kujdes me varkëtarin tjetër që mos përplaseshin.Ajo ja hodhi topin Mirkos që bëri një pritje të bukur spektakolare për kënaqësinë e tyre.Ata qeshën me zë dhe ndezën motorrat duke ndjekur anën e kundërt të rrymës. Gjithmonë në ikje para nesh derisa u zhduken ,na e bënin herë pas herë me dorë! Fjala Thank you na kish mbetur në buzë në një kujtim të bukur që s'do ta harronim kurrë.Ndonjëherë më ishte krijuar përshtypja se anglezët ishin të ftohtë.Nga mënyra si komunikonin të jepnin të kuptoje se ishin moskokëçarës me gotat e birrës jo deri në masën e dehjes, që s' i ndanin nga duart.

Dielli po përshëndetej me gjysmë diskun e hënës së sapodalë,që nuk kish marrë atë ngjyrën e ndritur të së verdhës së ndezur. Tisi i muzgut akoma nuk kish rënë e nëpër pemë dëgjoheshin levizjet e shpejta te ketrave ,qe s'e kishin mbaruar akoma lojën mes tyre.Ishim afruar pranë urës nga ku gurgullima e ujit dëgjohej më e fortë drejt rrjedhës së lumit.

*Angli*
*28 - 4 - 2018*

## Medalioni i Çmuar

*(Nga një ngjarje e vërtetë)*

Bari i sapokorrur në parkun e lagjes kish shpërndarë atë aromë të veçantë që t'i mbushte mushkëritë.Në rrethinat me parmakë hekuri të lyera me ngjyrë jeshile e të verdhë ndodheshin lodrat e fëmijëve si shilarëse, rrëshqitëse prej llamarine të shkëlqyer nga ku duhet të ngjiteshe me disa shkallë të vogla në ngjyrën e arrës.Pasi arrije në një dhomë të vogël në formë kubeje po prej dërrase mund të rrëshqisje lehtazi.në pjesën për të vegjël kishte elefantë e kuaj të gdhendur bukur me ngjyra të ndryshme që nën përflakjen e perëndimit me rrezethyerat që sikur zgjateshin me zor merrnin një nuancë të tyre e sikur tundeshin të heshtur.Të dy djemtë kishin marrë me vehte topin e kuq e filluan lojën me moshatarët e tyre në rrethinen e fushës që përdorej e për basketboll e futboll.Pas tyre në lojë hyri e një djalë dhjetëvjeçar.Babai i tij rreth të dyzetave u shtri ne bar për të ndjekur lojën me atë moskokëçarjen angleze.

Fëmijët sekush e donte në grupin e tij.Hodha sytë nga djali që e thërrisnin Gjosh. Nipërit po më shihnin me mëdyshje.Ç'të shihja? O Zot! Lëkura e tij ishte aq e lëmuar,aq e skuqur sikur

## Medalioni i Çmuar

*(Nga një ngjarje e vërtetë)*

Bari i sapokorrur në parkun e lagjes kish shpërndarë atë aromë të veçantë që t'i mbushte mushkëritë.Në rrethinat me parmakë hekuri të lyera me ngjyrë jeshile e të verdhë ndodheshin lodrat e fëmijëve si shilarëse, rrëshqitëse prej llamarine të shkëlqyer nga ku duhet të ngjiteshe me disa shkallë të vogla në ngjyrën e arrës.Pasi arrije në një dhomë të vogël në formë kubeje po prej dërrase mund të rrëshqisje lehtazi.në pjesën për të vegjël kishte elefantë e kuaj të gdhendur bukur me ngjyra të ndryshme që nën përflakjen e perëndimit me rrezethyerat që sikur zgjateshin me zor merrnin një nuancë të tyre e sikur tundeshin të heshtur.Të dy djemtë kishin marrë me vehte topin e kuq e filluan lojën me moshatarët e tyre në rrethinen e fushës që përdorej e për basketboll e futboll.Pas tyre në lojë hyri e një djalë dhjetëvjeçar.Babai i tij rreth të dyzetave u shtri ne bar për të ndjekur lojën me atë moskokëçarjen angleze.

Fëmijët sekush e donte në grupin e tij.Hodha sytë nga djali që e thërrisnin Gjosh. Nipërit po më shihnin me mëdyshje.Ç'të shihja? O Zot! Lëkura e tij ishte aq e lëmuar,aq e skuqur sikur

nuk arrinte të mbulonte mishin e gjallë.Vende vende kishte rrëkeza të lëngëzuara si të ishin të gatshme plagët për të rrjedhur.Kërkoja një pjesë pak më të pastër me vështrimin tim fshehurazi por ishte e pamundur.Ato pjesë që nuk e kishin atë përskuqje ishin si tëvrara lije.E tmerrshme! I gjithë trupi gjer e koka të lyera me një pumadë nga ku shkëlqente floku i verdhë i dalë aty këtu si me zor.Kish dy sy ngjyrë blu,thellësisht blu e të qeshur shumë të bukur.Ah ato sy dukeshin më shumë të menduar për një fëmijë.

- Do jetë ndeshje e bukur-m'u drejtua babai i tij me një theks të bukur anglez.

- Të shohim - iu përgjigja shpejt pasi e mora pak vehten nga nje dhimbshuri tejet e madhe që duhet ta fshihja shpejt.Kishin ngjashmëri te sytë me ngjyrën e blu si nje oqean i thellë.

- Nënë– m'u afrua nipi i vogël e më shumë po bënte sikur pinte me etje - E quajnë Gjosh.Nuk është sëmundje ngjitëse e ai do shërohet një ditë.Mos të kuptojnë qëje e prekur.Harroje! Do luajmë bukur- e më shkeli syrin.

-Keni kujdes mos e lëndoni gjatë lojës e i jepni mundësine të shënojë gola.

- Jo ma ktheu ai seriozisht në futboll nuk ka lëshime.

nuk arrinte të mbulonte mishin e gjallë.Vende vende kishte rrëkeza të lëngëzuara si të ishin të gatshme plagët për të rrjedhur.Kërkoja një pjesë pak më të pastër me vështrimin tim fshehurazi por ishte e pamundur.Ato pjesë që nuk e kishin atë përskuqje ishin si tëvrara lije.E tmerrshme! I gjithë trupi gjer e koka të lyera me një pumadë nga ku shkëlqente floku i verdhë i dalë aty këtu si me zor.Kish dy sy ngjyrë blu,thellësisht blu e të qeshur shumë të bukur.Ah ato sy dukeshin më shumë të menduar për një fëmijë.

- Do jetë ndeshje e bukur-m'u drejtua babai i tij me një theks të bukur anglez.

- Të shohim - iu përgjigja shpejt pasi e mora pak vehten nga nje dhimbshuri tejet e madhe që duhet ta fshihja shpejt.Kishin ngjashmëri te sytë me ngjyrën e blu si nje oqean i thellë.

- Nënë– m'u afrua nipi i vogël e më shumë po bënte sikur pinte me etje - E quajnë Gjosh.Nuk është sëmundje ngjitëse e ai do shërohet një ditë.Mos të kuptojnë qëje e prekur.Harroje! Do luajmë bukur- e më shkeli syrin.

-Keni kujdes mos e lëndoni gjatë lojës e i jepni mundësine të shënojë gola.

- Jo ma ktheu ai seriozisht në futboll nuk ka lëshime.

Fëmijët të bëjnë për vehte me çiltërsinë e tyre.

Gjoshi ishte fëmijë shumë i shkathët.u vu re që në fillim që ishte një lojëtar i shkëlqyer. Triplonte bukur duke lëvizur në të gjitha pozicionet ku skuadra e tij kishte dobësi. Kishte një nuhatje të çuditshme për të shënuar.Sa i shpejtë në mesfushor e mbrojtje po aq i fortë në sulm.Në zonën e rreptësisë me sigurinë e tij i pëlqente të shënonte me kokën ulur duke bërë një spektakël të vogël.

U bëra padashur njëtifoze e Gjoshit duke harruar që me nipërit e mi ishin kundërshtarë. Kur shënonte Gjoshi zemra më hidhej nga gëzimi e duartrokisja me ndonjë pasthirrmë.

Gjoshi përpëliste qerpikët e shkurtër e me buzëqeshte hareshëm.Loja përfundoi 5 me 3 e në mbarim të saj Gjoshi bënte shaka.Ishte hokatar e tëgjithë fëmijët e donin.Kur u ndamë desha ta puthja e ta shtërngoja fort fort në gji por këtu nuk e kanë zakon këtë. Ata të dy në të larguar ngritën e njëherë dorën për të na përshëndetur e dëgjova zërin e ëmbël të Gjoshit-bye...bye!

Dielli po fshihesh pas perëndimit duke e zbehur përskuqjen e tij e tërhequr pas vehtes rrezethyerat që reflektonin pas reve të përhimta

Fëmijët të bëjnë për vehte me çiltërsinë e tyre.

Gjoshi ishte fëmijë shumë i shkathët.u vu re që në fillim që ishte një lojëtar i shkëlqyer. Triplonte bukur duke lëvizur në të gjitha pozicionet ku skuadra e tij kishte dobësi. Kishte një nuhatje të çuditshme për të shënuar.Sa i shpejtë në mesfushor e mbrojtje po aq i fortë në sulm.Në zonën e rreptësisë me sigurinë e tij i pëlqente të shënonte me kokën ulur duke bërë një spektakël të vogël.

U bëra padashur njëtifoze e Gjoshit duke harruar që me nipërit e mi ishin kundërshtarë. Kur shënonte Gjoshi zemra më hidhej nga gëzimi e duartrokisja me ndonjë pasthirrmë.

Gjoshi përpëliste qerpikët e shkurtër e me buzëqeshte hareshëm.Loja përfundoi 5 me 3 e në mbarim të saj Gjoshi bënte shaka.Ishte hokatar e tëgjithë fëmijët e donin.Kur u ndamë desha ta puthja e ta shtërngoja fort fort në gji por këtu nuk e kanë zakon këtë. Ata të dy në të larguar ngritën e njëherë dorën për të na përshëndetur e dëgjova zërin e ëmbël të Gjoshit-bye...bye!

Dielli po fshihesh pas perëndimit duke e zbehur përskuqjen e tij e tërhequr pas vehtes rrezethyerat që reflektonin pas reve të përhimta

duke i dhënë nuancën e purpurt. M'u duk për një moment sikur u përzinë e qeshura e Gjoshit me dhimbshurinë time.

Ishte herët për të më telefonuar mbesa e u shqetësova se mos kish ndodhur diçka.

- Noni mirëmengjes! Kam një surprizë të bukur për ty.

Mendova mos ishte ndonje reng i vogël i saj për t'u çmallur.

- Do kthehesh sot? Kur të vish do ta tregoj.

- Po po - i thashë e mezi po mbaja të qeshurat.

Si me humorin ngacmues të saj atë ditë që do na përcillte gjyshit i vuri nofkën "Alien" pasi ai di t'i përgjigjet gjithë pyetjeve të kuriozitetit të saj , kurse mua m'u drejtua:

- Mos u vono shumë ditë priftëresha ime. Është bukur të udhëtosh ndërmjet dy qyteteve ku jetojnë fëmijët tanë.Pemët janë aq të larta nga dy anët e rrugës së gjerë të asfaltuar, saqë degëzimet e tyre në lartësi bashkohen duke formuar një tunel natyror të blertë ku dritëhija e futjes nëpër to të ndjell në një në një lojë romantike duke rrezatuar aty këtu. Këtu natyra është si një mbretëreshë virgjërie.Hapësira fushash pafund ku nëpërmjet gjelbërimit të

duke i dhënë nuancën e purpurt. M'u duk për një moment sikur u përzinë e qeshura e Gjoshit me dhimbshurinë time.

Ishte herët për të më telefonuar mbesa e u shqetësova se mos kish ndodhur diçka.

- Noni mirëmengjes! Kam një surprizë të bukur për ty.

Mendova mos ishte ndonje reng i vogël i saj për t'u çmallur.

- Do kthehesh sot? Kur të vish do ta tregoj.

- Po po - i thashë e mezi po mbaja të qeshurat.

Si me humorin ngacmues të saj atë ditë që do na përcillte gjyshit i vuri nofkën "Alien" pasi ai di t'i përgjigjet gjithë pyetjeve të kuriozitetit të saj , kurse mua m'u drejtua:

- Mos u vono shumë ditë priftëresha ime. Është bukur të udhëtosh ndërmjet dy qyteteve ku jetojnë fëmijët tanë.Pemët janë aq të larta nga dy anët e rrugës së gjerë të asfaltuar, saqë degëzimet e tyre në lartësi bashkohen duke formuar një tunel natyror të blertë ku dritëhija e futjes nëpër to të ndjell në një në një lojë romantike duke rrezatuar aty këtu. Këtu natyra është si një mbretëreshë virgjërie.Hapësira fushash pafund ku nëpërmjet gjelbërimit të

luledeleve zbardhin kamomila të bardhe me pushin e verdhë në mes të petaleve. Lulekuqe të tejçelura me dridhjen e tyre të lehtë e shumë fine nga një fllad i lehtë i freskët që të dehnin me aromën e tyre të përzier.Mahnitëse! Zhytesha herë pas here në kujtimet e ëmbla të kopështit të shtëpisë së fëmijërisë sime. Sapo arritëm pa u zhveshur akoma mbesa na u hodh në qafë.

U ula ne kolltukët të veshur me lëkurë në ngjyrë të zezë që shkonin me tapetin e trashë e të ngrohtë bezhe e u mbështeta në rehatinë time.

Tani mbylli sytë e po më vështronte ngultazi me ato sy të zinj me qerpikë të gjatë, të dendur e të kthyer paksa"

- hapi - e ku mos i bindesha asaj.

Në dorë mbante një kuti shumë të bukur. Nxorri nga ajo me kujdes një shishe të vogël parfumi. Shishja kish formën e rrumbullakosur gjer në mesin e saj duke përfunduar me një forme cilindrike metali të verdhë që t’i verbonte sytë me shkëlqimin.Aty rreth tij ishte lidhur një fjongo stolisur me një tufe fijesh të buta pellushi në ngjyrën ideje të ngjashme me ngjyrën e qelqit.

luledeleve zbardhin kamomila të bardhe me pushin e verdhë në mes të petaleve. Lulekuqe të tejçelura me dridhjen e tyre të lehtë e shumë fine nga një fllad i lehtë i freskët që të dehnin me aromën e tyre të përzier.Mahnitëse! Zhytesha herë pas here në kujtimet e ëmbla të kopështit të shtëpisë së fëmijërisë sime. Sapo arritëm pa u zhveshur akoma mbesa na u hodh në qafë.

U ula ne kolltukët të veshur me lëkurë në ngjyrë të zezë që shkonin me tapetin e trashë e të ngrohtë bezhe e u mbështeta në rehatinë time.

Tani mbylli sytë e po më vështronte ngultazi me ato sy të zinj me qerpikë të gjatë, të dendur e të kthyer paksa"

- hapi - e ku mos i bindesha asaj.

Në dorë mbante një kuti shumë të bukur. Nxorri nga ajo me kujdes një shishe të vogël parfumi. Shishja kish formën e rrumbullakosur gjer në mesin e saj duke përfunduar me një forme cilindrike metali të verdhë që t’i verbonte sytë me shkëlqimin.Aty rreth tij ishte lidhur një fjongo stolisur me një tufe fijesh të buta pellushi në ngjyrën ideje të ngjashme me ngjyrën e qelqit.

- Noni parfumi im i parë i imi me firmën origjinale të këngëtares Ariana Grande.

-Ti e di që jam fanse e saj.

U gëzova më shumë që ajo ndjehej e lumtur.

- Me çfare rasti ta dhuruan prindët? - e pyeta duke ngritur zërin por kafshova buzën. U ndje ngusht vajza e gjorë e shpejt tha merre ti po të pelqeu.

- Ta gezosh, dhuratë e bukur për ty.

Mbylli prap sytë- më detyroi çapkënia e vogël.

Kur i hapa më kish vënë në dorë nje medalion ku varej një lule me rruaza tejet të bardha e bojë qielli të ndara ndërmjet tyre me një prizëm të vogël të ndritshëm. Përfundonte me dy krahë fluturash të gdhendur me mjeshtëri si në shtresën fine të një serme e aty varesh si lavjerës një gur i tejdukshëm në formën e shkëlqimin si pikë e lotit. Sa i bukur qenka ky medaljon- i thashë e gëzuar.

- Është dhuratë për ty Noni!

Ndërmjet vogëlsirave të tjera që bleva po kërkoja diçka në shijen tënde. Më vjen keq që nuk është aq e shtrenjtë por janë disa punime artistike aq të bukura që duken si prej gurësh të vërtetë.

- Noni parfumi im i parë i imi me firmën origjinale të këngëtares Ariana Grande.

-Ti e di që jam fanse e saj.

U gëzova më shumë që ajo ndjehej e lumtur.

- Me çfare rasti ta dhuruan prindët? - e pyeta duke ngritur zërin por kafshova buzën. U ndje ngusht vajza e gjorë e shpejt tha merre ti po të pelqeu.

- Ta gezosh, dhuratë e bukur për ty.

Mbylli prap sytë- më detyroi çapkënia e vogël.

Kur i hapa më kish vënë në dorë nje medalion ku varej një lule me rruaza tejet të bardha e bojë qielli të ndara ndërmjet tyre me një prizëm të vogël të ndritshëm. Përfundonte me dy krahë fluturash të gdhendur me mjeshtëri si në shtresën fine të një serme e aty varesh si lavjerës një gur i tejdukshëm në formën e shkëlqimin si pikë e lotit. Sa i bukur qenka ky medaljon- i thashë e gëzuar.

- Është dhuratë për ty Noni!

Ndërmjet vogëlsirave të tjera që bleva po kërkoja diçka në shijen tënde. Më vjen keq që nuk është aq e shtrenjtë por janë disa punime artistike aq të bukura që duken si prej gurësh të vërtetë.

E psonisa në një panair të vogël që u bë pas partit të organizuar si bamirësi për Gjoshin.Veç ta shikoje noni sa i lumtur dukej.Ishte veshur elegant me një këmishë bojë qielli që i shkonte shumë.Aq shumë të ftuar sa ai i përcillte të gjithëve atë buzëqeshjen e tij të dlirë e vështrimin të menduar! Herë pas herë përqafonte gjyshen e tij që kishte të njëjtin problem me lëkurën e saj.

Diçka përsëri më sëmboi në zemër për të dy.E ndjeva që po më lëshonin forcat.

- Më prit pak zemër sa të vishem.

Hipa shkallët shpejt sa po me merrej fryma.Hyra ne dhomën time e u mbështeta pas derës, duke mbuluar fytyrën me duar.Shtërngimi në fyt po sillte dënesën e shpirtit në vrullin e lotëve tëkripur.Siç isha rashë përmbys në krevat.E mbështeta fort jastekun e butë e të bardhë në fytyrë që të mos dëgjoheshin ngashërime. Çfarë kish ndjerë ajo gjyshe për pafajësinë e trashëgimit në dhjetë vitet e vuajtjes së fëmijërisë së Gjoshit të saj? Cila plagë i dhimbte më shumë? Mos lëkura e saj kishte formuar një plagë të rrjedhshme në shpirt që nuk do të pushonte me burimin e shkëlqimin e lotit të fshehur?Ajo do ta falte atë shpirt sepse e kish ndjerë atë dhimbje, ndryshimin dita ditës të vragëve të saj.Mezi i

E psonisa në një panair të vogël që u bë pas partit të organizuar si bamirësi për Gjoshin.Veç ta shikoje noni sa i lumtur dukej.Ishte veshur elegant me një këmishë bojë qielli që i shkonte shumë.Aq shumë të ftuar sa ai i përcillte të gjithëve atë buzëqeshjen e tij të dlirë e vështrimin të menduar! Herë pas herë përqafonte gjyshen e tij që kishte të njëjtin problem me lëkurën e saj.

Diçka përsëri më sëmboi në zemër për të dy.E ndjeva që po më lëshonin forcat.

- Më prit pak zemër sa të vishem.

Hipa shkallët shpejt sa po me merrej fryma.Hyra ne dhomën time e u mbështeta pas derës, duke mbuluar fytyrën me duar.Shtërngimi në fyt po sillte dënesën e shpirtit në vrullin e lotëve tëkripur.Siç isha rashë përmbys në krevat.E mbështeta fort jastekun e butë e të bardhë në fytyrë që të mos dëgjoheshin ngashërime. Çfarë kish ndjerë ajo gjyshe për pafajësinë e trashëgimit në dhjetë vitet e vuajtjes së fëmijërisë së Gjoshit të saj? Cila plagë i dhimbte më shumë? Mos lëkura e saj kishte formuar një plagë të rrjedhshme në shpirt që nuk do të pushonte me burimin e shkëlqimin e lotit të fshehur?Ajo do ta falte atë shpirt sepse e kish ndjerë atë dhimbje, ndryshimin dita ditës të vragëve të saj.Mezi i

kish përballuar gjatë viteve vështrimet mëshiruese të njerëzve sa që kur ecte e mbante kokën ulur pa e kthyer prapa.Mos vallë ato largime të njerëzve të zemrës i kishin djegur më shumë se ato ravijëzime të lagështa? Ah Gjoshi i saj, përtej plagës e shpirtit të saj. Jo....jo sa herë ish gjunjëzuar në lutje hyjnore Zotit të saj për nipin e vetëm? Vallë a mundesh të përballonte që shpresa e tij të kishte ngjyrën e lëkurës së saj? Jo ..jo ëndrra e tij ishte në ngjyrën e syve të drejtuar nga qielli.

U ngrita shpejt e arrita të heq vetem xhupin e kapelën pasi mbesa po me thërriste me zërin e saj të ëmbël e unë sikur isha zgjuar nga një ëndërr me sy hapur që nuk e di i sa kishte zgjatur.

- Noni noni...eja!

Ajo e kish parfumosur medalionin me parfumin e saj të firmuar që kish shpërndarë një aromë të këndshme si prej një gonxheje e që kërkonte të çelej. M'u kujtua koncerti madhështor i këngëtares Ariana Grandes për bamirësi ku ajo shkëlqente me zërin e saj brilant e i emocionoje të gjithë. Noni ime fliste vajza me zërin që i dridhej pasi mbërtheu zinxhirin- ky medalion i ka të gjitha emocionet e mia, ngjyrat e tuaja pasi është blerë për një qëllim të mirë.

kish përballuar gjatë viteve vështrimet mëshiruese të njerëzve sa që kur ecte e mbante kokën ulur pa e kthyer prapa.Mos vallë ato largime të njerëzve të zemrës i kishin djegur më shumë se ato ravijëzime të lagështa? Ah Gjoshi i saj, përtej plagës e shpirtit të saj. Jo....jo sa herë ish gjunjëzuar në lutje hyjnore Zotit të saj për nipin e vetëm? Vallë a mundesh të përballonte që shpresa e tij të kishte ngjyrën e lëkurës së saj? Jo ..jo ëndrra e tij ishte në ngjyrën e syve të drejtuar nga qielli.

U ngrita shpejt e arrita të heq vetem xhupin e kapelën pasi mbesa po me thërriste me zërin e saj të ëmbël e unë sikur isha zgjuar nga një ëndërr me sy hapur që nuk e di i sa kishte zgjatur.

- Noni noni...eja!

Ajo e kish parfumosur medalionin me parfumin e saj të firmuar që kish shpërndarë një aromë të këndshme si prej një gonxheje e që kërkonte të çelej. M'u kujtua koncerti madhështor i këngëtares Ariana Grandes për bamirësi ku ajo shkëlqente me zërin e saj brilant e i emocionoje të gjithë. Noni ime fliste vajza me zërin që i dridhej pasi mbërtheu zinxhirin- ky medalion i ka të gjitha emocionet e mia, ngjyrat e tuaja pasi është blerë për një qëllim të mirë.

M’u duk sikur diçka më përkëdheli lehtë në lëkurë rreth qafës duke përçuar shpresën e ëndrrën e Gjoshit të vogël.

- Shpirti i vogël i Nonit! Është Medalioni më i Çmuar që më kanë dhuruar në jetën time.

- Noni ta gëzosh por kam diçka me tërëndësishme .

- Çfarë ....?

Gazeta lokale ka njoftuar se është zbuluar terapia e sëmundjes të trashëguar por e rrallë e Gjoshit.mKushton shumë. Kush do do ndihmojë me një paund.

Po me zmadhoheshin shqisat nga habia.

- Si the?

-Po noni në të tilla raste anglezët janë shumë të ndjeshëm.

U shtërnguam fort të dyja me lotët e gëzimit në ndjesinë e përbashkët. Ajo shpejt vuri muzikën me këngët e preferuar e tingujt e ëmbël melodiozë u shpërndanë hareshëm duke e mbushur gjithë dhomën.

Ai medalion i çmuar sikur mori shkëlqimin e një rubini përzier me ngjyrën blu plot shpresë të vështrimit të lumtur të Gjoshit!

*Angli*
*24-01-2018*

M’u duk sikur diçka më përkëdheli lehtë në lëkurë rreth qafës duke përçuar shpresën e ëndrrën e Gjoshit të vogël.

- Shpirti i vogël i Nonit! Është Medalioni më i Çmuar që më kanë dhuruar në jetën time.

- Noni ta gëzosh por kam diçka me tërëndësishme .

- Çfarë ....?

Gazeta lokale ka njoftuar se është zbuluar terapia e sëmundjes të trashëguar por e rrallë e Gjoshit.mKushton shumë. Kush do do ndihmojë me një paund.

Po me zmadhoheshin shqisat nga habia.

- Si the?

-Po noni në të tilla raste anglezët janë shumë të ndjeshëm.

U shtërnguam fort të dyja me lotët e gëzimit në ndjesinë e përbashkët. Ajo shpejt vuri muzikën me këngët e preferuar e tingujt e ëmbël melodiozë u shpërndanë hareshëm duke e mbushur gjithë dhomën.

Ai medalion i çmuar sikur mori shkëlqimin e një rubini përzier me ngjyrën blu plot shpresë të vështrimit të lumtur të Gjoshit!

*Angli*
*24-01-2018*

## Magjia e një nate

Në qytetin bregdetar të ardhur para disa kohësh, Silvana sikur e kishte kaluar atë hutimin e parë të daljes jashtë shtetit.

Apartamenti i përshtatshëm për të dy ishte afër qendrës. Punën e fillonte heret, duke u mahnitur me ngjyrat e qiellit të sapo zgjuar nga nata.Ylli i parë i mengjesit akoma farfurinte me zbehjen e tij e ajo sa herë e shihte i therriste nën zë emrin e Sokolit që me siguri ishte duke pirë kafen e mengjesit, ashtu shpejt e shpejt me cigaren e ndezur.

- Brunija ime me sy blu... e perkedhelte ai.... shpirti më i bukur Ti!

